

LAJMETARI

I BERATIT



Adresa: L. "30 Vjetori", tek stadiumi i vjetër
Tel & Fax ++ 355 32 36 932
Cel: 069 20 97 685

Viti III, Nr. 18 (139) E përjavshme e pavarur

E hënë, 9 maj 2006

Çmimi 20 lekë (1 Euro)

Adresa: Lagjia "Dëshmorët e Kombit", pranë shtypshkronjës "Lirsan Ekspres".

Tel: + 069 2247353

Adresa në internet: www.lajmetari.net

e-mail: redaksia@lajmetari.net

DEBAT

Kastriot Dervishi

**Hoxha, kryetari i ri
i PS-së, mbron
të korruptuarit, injorantët
që kishin kapur
institucionet në Berat**

Page 2

OPINION

Bardhyl Myftiu

**Marrëdhëniet
e ngushta
Kinë-Shqipëri**

Page 4

TRADITË

Bujar Orizaj

**Nga Ymer Berati te
Bajtjar Kafexhiu
një traditë e gjelbër**

Page 6

OPINION

Fejzi Murati

**KUR KA MOTIVIM
... (Një konkurs dhe
disa probleme)**

Page 8

EDITORIAL

Zhveshje e gjuhës, apo shplarje e trurit?!

Ndihmesa e organizatave joqeveritare që kanë vepruar dhe vepron në Shqipëri është dhe ka qënë e madhe në rrugën nga diktatura në demokraci. Njëpërmjet trainimeve, seminareve, ndihmave materiale, bisedave me qytetarët këto organizata e kanë lehtësuar disi udhën e mundimshme në këtë tranzicion. Natyrisht ka patur dhe ka mjaft shembuj të deformimit të funksionit të këtyre shoqatave, kur ato janë kthyer në ndërmarrje që u kanë shërbyer dhe u shërbejnë vetëm drejtuesve të tyre, duke devijuar në këtë mynyrë ndihmesën e taksapaguesve të Europës dhe Amerikës.

Sidoqoftë nuk është ky synimi i këtij shkrimi, por fenomeni qesharak, por edhe tragjik njëherësh që vërehet nga pjestarë, drejtues, apo edhe ndjekës të OJQ-ve.

Në emisionin "Zonë e Lirë", që transmetohet nga TV-Klan dhe drejtohet nga gazetari Artur Çani, pikërisht në emisionin e njëqindë të tij u prezantua një vajzë e vogël, vetëm 14 vjeç, e çila rezultoi drejtuese e një OJQ-je për të rinj Kur ajo nisi të fliste, të gjithë ata që e kanë ndjekur këtë emision do të kenë vënë re se gjuha e saj nuk ishte gjuha e një fëmije 14 vjeç, nuk ishte gjuha e një vajzë në klasën e shtatë të shkollës 9-vjeçare, nuk ishte as gjuha e një nxënësi mesatar, as gjuha e një nxënësi të shkëlqyer në mësim. Ishte një gjuhë pa moshë, e pavarur nga shkolla, pa nivel çulture, pa ngjyrë. Ishte një gjuhë e ftohtë llamarinë, e çminalizuar nga çdo pasuri leksikore, e çminalizuar nga çdo formë tingullore dhe sintaksore. Ishte një ligjërimit që të kallte datën për nga mungesa e njerëzores, nga mungesa e gabimeve të natyrshme të moshës dhe shkallës së njohjes, një ligjërimit prej roboti që nuk përcillte asnjë kumt njerëzor, një gjuhë uniforme prej luftëtarësh. (Fëmija 14 vjeç kishte marrë përsipër të emanciponte politikën dhe gjithë jetën shoqërore në vend, mesa mundëm të kuptonim nga fjalët e saj) Një shformim të tillë, të denjë për t'u shfaqur vetëm në një emision plot gjetje të kësaj natyre si "Zonë e Lirë", e ndeshim edhe në ëorkshope, konferenca, takime dhe biseda që zhvillojnë çdo ditë OJQ të ndryshme. Djem dhe vajza, burra e gra, të shkolluar dhe të paarsimuar flasin të njëjtën gjuhë të zhveshur dru, të njëjtën gjuhë të çminalizuar, pa individualitet si kokrriza e rërës. Kur e dëgjon këtë mënyrë të artikulluarit (as që bëhet fjalë për një formë të menduarit), pyetja e parë që të lind është: Në çilën OJQ bëni pjesë zonjushë, zonjë a zotëri i nderuar?

Edhe më e dukshme dhe më e dëmshme bëhet kjo dukuri kur zyrtarë të shtetit, ardhur nga përvoja të gjata OJQ-sh komunikojnë me qytetarët me këtë gjuhë të karakumit. Qytetari që bie në kontakt me këto specie, i hutuar nga moskuptimi tund kokën dhe bëlbëzon: nëç, nëç, nëç, nëç...! Sa i ditur që është! Foli një orë të tërë pa ndsalim dhe unë i mjeri nuk kuptova asgjë!

Kur dëgjon këtë gjuhë qukapikësh vëren se shplarja e trurit, djerrina e shpirtit nuk ndodh vetëm në diktaturë, por edhe në tranzicionin e saj për në demokraci. Kjo dukuri nëse do të përhapet dhe do të bëhet mbizotëruese do t'i sjellë një dëm të pallogaritshëm gjuhës si mjet komunikimi dhe identitet kombëtar, formuar gjatë shekujve, do t'i sjellë një dëm të madh vazhdimësisë intelektuale dhe shpirtërore të banorëve të këtij trualli.

Yzedin Hima



Berat, 5 Maj 2006

Pozita dhe opozita kanë vënë kurora me lule në varrezat e dëshmorëve në Berat. Titullarë nga prefektura, bashkitë dhe të institucioneve të tjera të Beratit kanë bërë homazhe dhe kanë marrë pjesë në ceremoninë e rivarrimit të katër trupave të shpallur dëshmorë, por që deri dje nuk preheshin në varrezat e dëshmorëve.

Më pas përfaqësues të pushtetit dhe të forcave politike kanë bërë vizita në famljet e dëshmorëve.

Simon Vrusho

**NXENESIT ME IDE NE
VEMENDJEN E MESUESIT**

Page 10

Rrëfenja

nga Agim Mehqemeja,
Enver Troka

Page 14

Faqja sportive

nga Vlash Pambuku,
Rushan Dosti,
Vangjel Buda

Page 15-16

Jon Impex

AGJENSI TRANSPORTI UDHËTARËSH

Bileta autobusi për Greqi (Janinë-
Rio-Athinë)

Bileta trageti për Itali

Bileta avioni për Itali

19 EURO (Pa taksa)


Tel. 032 31 565

Cel: 068 22 63 650

Lagjia: "22 Tetori" pranë Bar "Prince"

Si mund të mbronit automjetet tuaja?

TEXACO



Goma të ndryshme

ALDOM

Përdorni vajra të cilësisë së lartë

KËTU DO TË GJENI me shumicë dhe pakicë:

Shell



FILTRA



Bateri të cilësisë së lartë

Pjesë këmbimi me porosi për automjete të rënda (eskavator, fadrom, traktor, kamion, etj)

Adresa:

Tek Parku i Urës Vajguore
Përballë Western Union

Administrator: Edison Fitim Beshiri
Tel: 0682235888; 0692052522



Qytetarët shqiptarë në 3 korrik flakën qeverisjen më të korrumpuar në botë

Hoxha, kryetari i ri i PS-së, mbron të korrumpuarit, injorantë që kishin kapur institucionet në Berat

Ajo që është tepër e rëndësishme, duket qartë funksionimi i shtetit, veprimi i ligjit. Disa ish drejtues të korrumpuar kanë përfunduar në duart e drejtësisë, të tjerë do të pasojnë. I premtuam elektoratit vendosjen e shtetit ligjor, tolerance zero ndaj krimit, zhdukje informaliteti në ekonomi, atë po bëjmë po mbajmë premtimet elektorale.

Kryetari i ri i Partisë Socialiste të Beratit, në të parën deklaratë për shtyp të mbajtur më datë 4 maj, në tv. "Onufri", me një breshëri të paparë, ekzekutoi qeverisjen e PD-së në bazë dhe në qëndër. Me patetizëm ai konfirmoi edhe njëherë se nuk e ka kuptuar që ka humbur më 3 korrik dhe se populli i largoi nga qeverisja si qeveria më e korrumpuar e globit.

Nuk dua të përsëris ato që tha zoti Hoxha, por jam i detyruar të jem korrekt me lexuesin për atë që do të argumentoj më pas. Po e përshkruaj shkurt thelbin e deklaratës që lexoi me tërsëllmë lideri socialist i Beratit: "Asgjë nuk ka ndryshuar, ngrije

çmimesh, tatime fiktive, errësirë, investimet nga pushteti qendror zero, nivel i lartë papunësie, pagat dhe pensionet po ulen, qeveria Berisha 2 nuk ka ndryshuar nga qeveria Berisha 1, varfëri absolute, 250 socialistë të larguar nga puna, 25 drejtorë të larguar, 50 specialistë të hedhur në rrugë, 145 lëvizje në arsim, të arsimuarit me tetëvjeçare po zënë vendin e atyre me të mesme, ata me të mesme vendin e të lartit, pasiguri e vendit të punës, militantët e PD-së fyejnë të PS-së, janë vendosur drejtorë të papërgjegjshëm, nuk priten ndryshime, reformë politike etj, et, e,..."

Por më e çuditshmja paska ndodhur në '97 kur erdhën në pushtet socialistët: "Ne nuk gjetëm drejtues në institucione, prandaj i zëvendësuam vendet bosh!"

Po e nis nga fundi i deklaratës, pikërisht nga koha kur socialistët në '97-ën i gjetën bosh vendet dhe i zëvendësuan. Zoti Hoxha, përse nuk deklaroni që vendet i hapët me kallash në dorë? Që ndryshuat vetëm llojin e armës, sepse shqiptarët rrugën e kishin çarë me shpatë në dorë, apo jo?! Për 8-të vjet ju bëtë spastrim etnik, i hoqët të drejtën e punës demokratëve dhe pasi mbaruat me ta, filluat brenda llojit duke i detyruar shqiptarët të lënë vendin e tyre.

Përsa i përket kësaj teme shqiptarët më 3 korrik përdorën armën më efikase të demokracisë, votën, për të zëvendësuar rezultatet e '97-ës. Socialistët i ndëshkoi populli si të korrumpuar. Shikoni vilat si i kanë bërë! Mjafton të sillni ndër mend një ish-zyrtar të arsimit, e cila ka blerë shtëpi luksoze në Tiranë duke u shitur diploma fallco "mësuesve" militantë të PS-së, ndërkohë që ligjërisht zyra e saj duhet të verifikonte diplomat dhe dëftesat fallco. Nëse ju si drejtues i PS-së kërkonte emra dhe mbiemra, herës tjetër do t'ju japim me fakte këto.

Besoje se është e qartë dhe nuk ia vlen të zgjatem me këtë argument. Ne nuk i gjetëm vendet bosh, por i morëm sipas të drejtës që na e ka deleguar shumica e shqiptarëve. Nuk e keni kuptuar që keni humbur pushtetin dhe si rrjedhojë do të lini edhe vendet?! Hidhini një sy ish -drejtuesve, edhe atyre aktual në pushtetin lokal, ata të bëjnë për të qeshur me injorancën dhe fudullëkun e tyre, kanë zëvendësuar humorin e munguar në Berat. Të gjithë drejtuesit e rinj, janë, jo më njëlloj, por më të mirë se ish-drejtuesit e PS-së nga ana profesionale dhe intelektuale dhe personalitete të përgjegjshëm. Papërgjegjshmëria mori fund më 3 korrik.

Me lehtësi mund të të jap fakte të cilat kundërshtojnë deklaratën tuaj, për t'ia bërë më të qartë lexuesit idenë e shkrimit. Mjafton të përmendim investimet e qeverisë: 200 milionë për fizibilitetin e rrugës Elbasan- Berat- Gjirokastër, 40 milionë për projektin Ura e Re në Goricë, 2 milionë dollarë për rrugën Ura e

Kuçit - Berat, zgjidhjen e problemit të ujit të Bogovës, mbushjen e gropave në rrugën nacionale, pastrimin e lumit midis dy urave. (Hidhini një sy rrugëve në qytet, rrugëve me sipërmarrje në Lapardha e në zonat rurale punimeve pa kontratë të 20 kilovoltshit, që janë nën administrimin e socialistëve!). Tatimet, vetëm në tremujorin e parë 300 biznese të vegjël më shumë, nga 50 milionë tremujorin e parë në 2005-ën për tatimin e thjeshtuar dhe taksën vendore, u ulën në 25 milionë në 2006-ën, 13 milionë të reja më tepër të mbledhura në rrugë ligjore. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i miradministrimit. Është e vërtetë që janë hequr punëtorët politikë që mbanin në mënyrë të paligjshme 300 biznese dhe janë zëvendësuar me specialistë. Në dogana 50 milion euro më tepër se 4-mujori i vitit të kaluar në shkallë republike. Kafaja dhe cigaret janë zhdoganuar 350 % më tepër.

Në arsim të gjithë drejtorët dhe inspektorët që përmendi kryetari socialist, të cilët janë zëvendësuar, kanë emrin në listpagesat e llogarisë së paligjshme, e cila çuditërisht është mbajtur si llogaria më e saktët duke e krahasuar me llogarinë e ligjshme. Duke trafikuar libra, fletore, janë këta ish- drejtorë të shkollave që kanë shitur dëftesa fallco, deri në 2 milionë lekë, duke mbushur rajonin e Beratit me "mësues" me katër klasë. Janë këta ish- drejtorë të kapur me presh në dorë, këtë e vërtetojnë edhe gjyqet me DAR-in, të cilët i kanë humbur të gjithë. Në drejtorinë arsimore nuk kishte asnjë demokrat, por vetëm socialistë dhe njerëz afër tyre.. Natyrisht socialistët e aftë me integritet profesional janë sot drejtues në të tëra hallkat. Arsimi i takon qytetarëve, ndërsa ish- drejtorët e kishin kthyer shkollën në shkollë në shërbim të politikës.

Investimet e qeverisë Berisha në arsim janë rritur dyfish, investime të cilat po i lëvrojnë pushtetarët lokalë socialiste. Matura shtetërore do t'i kthejë nderin e humbur arsimit shqiptar.

Dua t'ju kujtoj luftën e shkëlqyer të policisë së shtetit kundër krimit të organizuar, si dhe kapjen e bandave kriminale, çlirimin e Lushnjës dhe të Durrësit, jam i sigurt që edhe ju ndiheni i lëhtësuar nga makthet kriminale. Ajo që është tepër e rëndësishme, duket qartë funksionimi i shtetit, veprimi i ligjit. Disa ish- drejtues të korrumpuar kanë përfunduar në duart e drejtësisë, të tjerë do t'i pasojnë. I premtuam elektoratit vendosjen e shtetit ligjor, tolerancë zero ndaj krimit, zhdukje informaliteti në ekonomi, atë po bëjmë po mbajmë premtimet elektorale.

Kastriot Dervishi,
Sekretar i marrëdhënieve me publikun
në Partinë Demokratike Berat

32- vjeçari Agur F. Tafa në udhëkryq

Mjekët maqedonas e nxjerrin nga spitali për arsye financiare

Është vetëm 32 vjeç. I martuar dhe me dy fëmijë. Mblidhte hekurishte në çdo fshat dhe në mbrëmje kthehej pranë familjes. Por kjo nuk zgjati shumë dhe Aguri aksidentohet ndërsa ngarkonte, me një vinç në shtyllën kurrizore dhe siç tregon vetë, që në çastin e aksidentimit, u paralizua. "Këtë çast, -thotë Aguri,- e mbaj mend, ndërsa disa djem nga Drenovica, vendi i aksidentit, më çuan urgjentisht në spital.

Mjekët në Berat e nisën në Tiranë dhe pas ndërhyrjes operatore në shtyllën kurrizore, Aguri nuk pati përmirësim dhe humbi aftësinë për të punuar. Kanë kaluar dy vjet nga kjo histori dhe 32 -vjeçari ndodhet në udhëkryq ndërkohë që dy fëmijët e tij dhe bashkëshortja, Alma, kanë nevojë për ushqim dhe veshmbathje. Aguri trajtohet si invalid dhe siç tregon gruaja e tij Alma, 6300 lekë të reja në muaj që merr nuk i dalin për asgjë. E vetmja pasuri e tij është kjo karrocë me tre rrota që e shtynjë fëmijët nëpër oborr. Pa e ofenduar 32 -vjeçarin, vendi ku jeton është për të vënë duart në kokë, siç themi nga anët tona. Një dhomë me blloqe, mbuluar me llamarinë. Nuk po flas për orënditë shtëpiake, sepse nuk dua të nxjerr në pazar për ato që pashë. Dy televizione kanë ardhur në familjen Tafa për të sensibilizuar

opinionin dhe për t'u njohur nga afër me paraplegjikun dhe kushtet ku jeton, por gjithsesi Aguri e quan ndihmë morale edhe televizionet dhe gazetën dhe na falenderon që shtypi i shkruar dhe mediat elektronike bëjnë për të sëmurët. Aguri ka dy dynym tokë, të cilën ai dhe familja e tij nuk janë në gjendje për ta punuar, sepse toka, thotë gruaja e tij, kërkon punë krahu dhe para. Ne, shton ajo, nuk kemi lekë për të blerë ushqime, na vjen keq për djalin kur shkon në shkollë për t'i dhënë një 200 lekësh të vjetër për të blerë një byrek. Morëm ca lekë borxh dhe e çuam Agurin në Maqedoni për të bërë operim, pasi një mjek atje doli garant për t'i kthyer 50% të aftësisë, të paktën të ecte me këmbët e tija. Por shuma e parave të marra borxh, nuk mjaftuan për vizita dhe disa masazhime që i bënë Agurit. Kurse unë haja vetëm një herë në ditë se nuk i përballoja dot shpenzimet. Shkuam me shpresë të madhe në Maqedoni, por ata e kishin mendjen vetëm te lekët dhe me ç'pamë mungonte shpirti human. Këtë e tregoi dhe arroganca e tyre kur na nxuarën fishekë dhe jashtë spitalit. Më keq nuk kishte, sepse nuk kishim lekë për të adhur në Shqipëri, deri sa i telefonuam një njeriut tonë që na mori. Kam dëgjuar, thotë Aguri, që mjekët tanë i shajnë, tani them me bindje se i shajnë kot. Mjekët

tanë nuk bëjnë pazar me jetën e njeriut. Ja unë jam i kënaqur nga mjekët tanë që më kuruan, sidomos profesor doktor Mentor Petrela, pavarësisht rezultatit, po kush të fut në spital në Maqedoni pa parapaguar njëherë, ndryshe nuk të qas njeri as te porta. Mjekët maqedonas i kërkuar Agurit 14 000 euro për ta operuar. Kur më thanë këtë, tregon Aguri, vura duart në kokë, sepse nuk i kam parë në ëndërr. Gjithë miqësia më kanë dhënë borxhe dhe një pjesë dhe mi kanë faluar, por nuk kam mundësi që t'i siguroj gjithë këto para. Përveç sëmundjes së tij Aguri ka dhe djalin të verbër, i cili ka humbur dhe ky 70% të shikimit.

I ndodhur në këto kushte, Aguri nëpërmjet kësaj gazete apelon gjithë dashamirësit për ndihmë financiare sipas mundësisë që kanë. Siç thotë me lot Alma, jemi në pikë të hallit, por të paktën të më ishte shëruar burri se është i ri, por dhe djali sa vjen dhe rëndohet, është në klasën e parë dhe mezi lexon. Aq të vështira janë kushtet, sa nuk kemi një lopë për një pikë dhallë dhe shtëpi për të futur kokën.

Ky ishte Agur Tafa nga fshati Goriçan, i cili pret më shumë nga shteti dhe shoqëria.

Nezir Vrapit

Marrëdhëniet e ngushta Kinë-Shqipëri

Bardhyl MYFTIU

Shqipëria vazhdon të ketë edhe sot marrëdhënie shumë të ngushta me Kinën komuniste. Madje shumë deputetë, përfshirë edhe të djathtë, të cilët kanë vizituar Kinën, shprehen me entuziasëm për bumën ekonomik të Kinës dhe gati sa nuk thonë se Kina është demokratike. Asnjëherë e majta shqiptare nuk ka zënë në gojë tmerret e Kinës komuniste të Mao Ce Dunit, sepse më parë do të denonconim krimet e Enver Hoxhës dhe të komunizmit shqiptar.

Po kush është me të vërtetë Kina e djeshme dhe e sotme?

Gjatë fushatës elektorale në Itali, Berlusconi denoncoi te tha se komunistët kinezë kanë zier fëmijë. Sipas gazetës LIBERO, kjo deklaratë e Berluskonit nuk është një shpikje e tij.

Që në Kinën e M.C.D.janë zier njerëz të gjallë, është provuar në vitin 1960 kur Komisioni Ndërkombëtar i Juristëve të Gjenevës, shoqata e pavarur kjo e përbërë nga avokatë, gjyqtarë, docentë nga 50 vende të botës bënë bilancin e represionit të revoltës së Tibetit.

“Dhjetëramijë tibetianë janë vrarë në bazë të dyshimit për veprimtari antikomuniste. Ata janë vrarë, rrahur për vdekje, pushkatuar, kryqëzuar, djegur në zjarr të gjallë, mbytur në ujë dhe mbytur në litar, hedhur në ujë të valuar dhe shumë të burgosur, ndjekur më pas me brutalitet primitiv dhe detyruar me punë të rënda. Atje u aplikua operacioni i shterpëzimit me detyrim, me qëllim eliminimin e racës tibetiane, duke bërë martesë të detyruara me kinezë, që pas disa brezash të shkatërrohej si racë.

Ushtria kineze bombardoi dhe

shkatërroi qindra manastire, ndërsa të tjerët u rrafshuan për tokë. Në bazë të këtyre fakteve dhe provave të marra, Komisioni Ndërkombëtar i Juristëve e deklaroi Republikën Popullore të Kinës fajtoreshë për genocid, për zhdukjen e tibetianëve si grup etnik, racial dhe fetar.

Sipas qeverisë tibetiane në mërgim, regjimi komunist kishte vrarë 1 milion e 200 mijë njerëz, baraz me 25% të popullatës.

Qeveria e Republikës Popullore të Kinës e ridimensionon këtë denoncim, por pranon se midis viteve 1955-1959, në Tibet ka patur të paktën 65000 të vdekur, nga të cilët 40 000 viktima të bombardimit. Gjithashtu pranon se të paktën 87 000 tibetianë janë ekzekutuar dhe pushkatuar 200 000 fëmijë janë deportuar. Natyrisht mund të mendohet se historia e RPK është një faqe e errët.

Por tibetianët nuk janë e vetmja minorancë etnike që u shtyp nga regjimi komunist. Falë personalitetit të madh të Dalai Lamës, ata kanë gjetur në perëndim një vëmendje të madhe.

Nëse do të shohim mongolët në Mongolinë e Brendshme, zbulojmë se nga shifrat e njoftuara nga vetë Partia Komuniste kineze pas likuidimit të të ashtuquajturës “Banda e Të katërve”, flasin për 22 900 të vdekur ose baraz me 1% të popullatës vetëm në vitet 1966-1969. Por burime të tjera thonë se të paktën 50 000 u shtohen asaj shume atëherë del se 120 000 mongolë janë “sakatosur”, mijëra familje barinjësh janë deportuar me forcë dhe kanë gjetur vdekjen mijëra të tjerë.

Nga ana tjetër, informacionet që disponohen për periudhën maoiste thonë se tepërimet janë bërë në të gjithë vendin. Një studim i vitit 1991, vlerëson viktimat e regjimit komunist në 20 milionë, nga të cilët



4 milionë në vitin 1949-1958 dhe 10 milionë nga viti 1959-1967. Vetëm fushata e vitit 1950-1951 “për eliminimin e elementëve kundërrevolucionarë” shkaktoi 1 milion viktima në tre qytete dhe 3 milionë në fshatra. Më se 700 mijë njerëz u detyruan ose u shtynë në vetvrasje.

Por, po të shtosh edhe viktimat e urisë së madhe e provokuar nga politika e çmendur agrare e “Hopit të madhe” e viteve 1959-1961, dalin 15-30 milionë të vdekur. Pastaj është edhe historia e Loagait, gulagu kinez me 2500 qendra burgu, ku 1 milion të burgosur, në burgjet e sigurisë së lartë dhe 1 milionë të tjerë në kampet e punës, në të cilët deri në vitin 1980 kaluan 50 milionë ku vdiqën 20 milionë.

Kjo nuk është vetëm një llahtari e të shkuarës. Numri i Leogarëve dhe i të burgosurve është sekret shtetëror në Kinë, por grupi i Punës dhe i Kombeve të Bashkuara për punën e detyruar dhe dënimet arbitrarë është dhënë në një raport të vitit 1997, pas një udhëtimi në Kinë, i cili çmonte se të paktën 230 mijë njerëz ndodhen në 280 kampe, ndërsa Laogarin një Fondacion i Research, ka individualizuar të paktën 1000 kampe dhe numri i të burgosurve është midis 4-6 milionë.

Sot në Kinë ekzekutohen çdo vit 10 mijë njerëz dhe për të parë ekzekutimin çojnë fëmijët e moshës 6-16 vjeç. Çdo fyerje për

Maon sot dënohet me 30 vjet burg. Viktimat e ekzekutimit përdoren si sebatore të organeve për tansplant. E majta sot harron se sot në Pekin tallen me të drejtat e njeriut, duke vazhduar kështu të vrasin e të torturojnë në heshtje komunitetin ndërkombëtar.

Pas gjithë këtyre marrëzive të sistemit komunist, ende sot në Shqipëri nuk është dënua formalisht komunizmi siç e kërkon edhe rezolura e Komitetit Evropian. Madje shtypi shqiptar u bën reklamë ishkrerëve të diktaturës enveriane. Ata hiqen si heronj pa shfaqur as pendimin më të vogël për krimet e tyre.

Me sa duket Shqipëria është vendi më pjellor në botë për njerëz të tillë. Që kur u bë Shqipëria një vend kaq demokratik sa të lejohet kriminelë të demonstronjë forcën e të mburren për krimet e tyre në diktaturë? Shqipëria nuk duhet të harrojë se para disa muajsh në Austri u dënua një publicist edhe pse ishte 90 vjeç me 4 vjet burg, vetëm pse shkroi se regjimi nazist nuk kishte bërë genocid ndaj popullatës ebre.

Te ne ende demonstronjë në raste festash demonët e të kalaurës me portretet e diktatorëve, duke filluar nga Enver Hoxha, Stalini dhe duke përfunduar te Che Guevara dhe një ditë ata do të dalin edhe me portretin e Bin Ladenit.

KONSULLATA E PËRGJITHSHME NË VLORE

KOMUNIKATE PËR SHTYP

Konsullata e Përgjithshme e Italisë në Vlore njofton qytetaret shqiptarë se kërkesat për takim, viza, legalizime e validime mund të kryhen duke telefonuar në numrin 0900 707 4001, nga e hëna deri të premten, nga ora 16.⁰⁰ deri në 20.⁰⁰. Ky shërbim kushton 100 leke në minute plus TVSH. Lajmërojmë se gjate telefonatës duhet patur me vete pasaporta e kërkuesit të takimit, sepse të dhënat e saj do t’ju kërkohen nga operatori telefonik.

Në këtë mënyrë, qytetaret do të marrin menjëherë vesh datën e

takimit të tyre si dhe çdo lloj informacioni në lidhje me dokumentacionin e plote që duhet paraqitur bashkë me kërkesën për vize.

Në rast se ka një urgjence të motivuar e të jashtëzakonshme si dhe zotërohet dokumentacioni i plote, çdo qytetar që kërkon vize për kure mjekësore, ftese për gjyq, rihyrje, punësim me kontrate sezonale, bursa studimi apo familjar i shoqëruar nga shtetas italian, mund të hyjë në Konsullatën e Përgjithshme pa takim, çdo ditë pune, nga ora 08.³⁰ deri në 11.⁰⁰. Në një rast të tillë, i interesuari duhet të

paraqitet drejt e të policet e Aulonapolit në hyrje të Konsullatës së Përgjithshme, të cilët do ta lejojnë të hyjë menjëherë në sallën e pritjes, ku do identifikohet nga karabinierët. Me këtë rast, kujtojmë se do të denoncohet çdo person që hyn ose përpiket të hyjë pa takim, pa patur realisht një nga arsytet e sipërpërmendura. Përpara se të paraqiteni për takim, ju sugjerojmë që të telefononi në numrin 0900 707 4001, me qëllimin e dyfishtë që të merrni informacion për dokumentacionin e plote që duhet të paraqitni si dhe për

të pare mundësinë e marrjes se takimit brenda afatit të duhur.

Sqarojmë se, në datën e takimit, pasi të kenë paraqitur kërkesën për vize apo legalizim, qytetaret, para se të dalin nga Konsullata e Përgjithshme, duhet të drejtohen tek sporteli i Union Express për dorëzimin në shtëpinë e tyre të pasaportës apo dokumenteve. Pasi të kenë kryer edhe këtë veprim, qytetaret dalin nga Konsullata e Përgjithshme dhe, brenda orës 12.30 shkojnë te Banka Italo-Shqiptare në Vlore për të kryer pagesën e taksave konsullore që i detyrohen shtetit për shërbimet e kërkuara.

Kujtojmë qytetaret se për të hyrë në Konsullatën e Përgjithshme të Italisë është e domosdoshme të paturit me vete i një pasaporte të vlefshme dhe se hyrja në çdo rast është falas.

Theksojmë se Konsullata e Përgjithshme nuk ka as agjensi, as ndërmjetës të jashtëm apo të brendshëm. Kujtojmë se punonjësit e mbikëqyrjes e të rendit publik në sheshin para Konsullatës së Përgjithshme nuk kanë asnjë kompetence për shërbimet konsullore, prandaj nuk mund e nuk duhet të japin sqarime apo informacione për to, qofte edhe falas. Konsullata e Përgjithshme nuk ka asnjë lidhje me aktivitetin tregtar

në lokale apo ambulant që gjendjet përreth saj. Ftojme qytetaret që mos të kërkojnë të ashtuquajturat rruge të shkurtra, por të denoncojnë cilindo mashtrues që, në këmbim të parave apo çdo shpërblimi tjetër, përpiket të hiqet sikur mund të ndërhyjë apo shpejtoje një praktike. Çdo qytetar që i drejtohet ndërmjetësve e mashtruesve do të denoncohet bashkë me kriminelet e sipërpërmendur. Nënvizojmë se e vetmja pagese që duhet të kryejnë qytetaret për shërbimet konsullore italiane është ajo e taksave konsullore që kryhet vetëm te Banka Italo-Shqiptare.

S'të plak moshë, por mungesa e përkushtimit, pasionit ndaj detyrës

Në qendrën kulturore të fëmijëve para disa ditësh u zhvillua një veprimtari mbresëlënëse në saj të një pune plot pasion e përkushtim të mësuesëve të shkollës "1 Maj" e në veçanti e mësueses veterane Dafina Stajko. Bashkëpunim i ngushtë midis mësuesëve të historisë, edukatës dhe muzikës e bënë këtë veprimtari jo vetëm gjurmëlënëse, por dhe shumë dominuese me dëgjuesin nxënës, mësues, prind. Në këtë spektakël ku ndihej nga afër thënia e të madhit Naim "Drita e diturisë përpara do t'na shpjerë".

Veprimtaria ishte një konkurs midis klasave VIII

me tematikë "Të njohim vendlindjen".

Ishin 3 grupe që mbartnin emërtesa autoktone: Gorica, Mangalemi, Kalaja.

Pyetësi ishte sa formues dhe kërkues për të njohur sa më mirë djepin e vendlindjes, Beratin e lashtë, të kodikëve, të Onufrit, të legjendës (Konstandinit të madh, Babë Dudës dhe të paharruarit mendjendritur Vexhi Buharasë që po troket në portën e kujtesës njerëzore në UNESKO.

Veprimtarinë e çeli mësuesja znj. Dafina, ndërsa drejtimi i ishte besuar nxënësës tashmë të njohur në

festivalet e fëmijëve si fituese e çmimeve, Inis Dardha.

Në mes pauzave kishte intermezo me recitime nga vetë nxënësit, këngë popullore që e drejtonte vetë orkestrën e shkollës, kuriozitet të ndryshme.

Punë të lavdërueshme kanë bërë dhe në krijimin e albumeve të ndryshme me pamje nga Berati me aparatën e tyre.

Konkursin e fitoi Mangalemi me diferencë të vogël.

Me të drejtë mund të themi se mësuesin nuk e plakin vitet, por mungesa e përkushtimit, pasionit për këtë profesion sa fisnik, human e njerëzor.

Sotiraq Mishaxhiu

Veprimtaria dhe ndihma e Kryqit të Kuq në sytë e fëmijëve

U në nuk do të kisha shkruajtur këtë artikull, nëse nuk do të kisha ngelur e mahnitur dhe tepër e impresionuar nga një vizatim që më ra në dorë gjatë ditëve që bëhej grumbullimi i punimeve për konkurim "Fëmijët dhe Kryqi i Kuq". Dhe ky ishte një punim që shprehte botën e një fëmije 5-vjeçare, vogëlushes Sindi Omenaj. Në këtë vizatim shihej ndihma dhe përkrahja që duhet t'u jepet njerëzve në nevojë: Bëhet fjalë për organizmin e një konkursi vizatimi në shkollë qarku me pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve të shkollave nëntëvjeçare të qytetit të Beratit, Kuçovës e Skraparit.

Flitet për një konkurs, i cili zhvillohet çdo vit. Ky aktivitet u inicua nga Dega e Kryqit të Kuq Berat dhe gjeti përkrahje dhe mbështetje të plotë nga drejtorja arsimore, qendra kulturore e fëmijëve dhe biblioteka "Vexhi Buharaja".

Për të pasur një pjesëmarrje sa më të gjerë dhe një aktivizim masiv të fëmijëve, për t'i mbështetur ata, u dhanë orientime konkrete mësuesëve të vizatimit në shkollat nëntëvjeçare të qytetit nga kordinatori i projektit.

Tematika e punimeve të fëmijëve ishte e ndryshme dhe e larmishme dhe në to shprehej bota fëmijore e lidhur kjo me ndihmën ndaj fatkeqësive natyrore që Kryqi i Kuq iu jep njerëzve. Në ato punime shpreheshin qartë të gjitha aktivitetet e ndërmarra nga Kryqi i Kuq dhe që pasqyroheshin me çiltërsi e naivitet fëmijor në vizatimet e bëra nga fëmijët. Në këtë aktivitet masiv u përfshinë vullnetarët të Kryqit të Kuq së bashku me grupin e punës dhe vullnetarët që oeprojnë në shkollat e qytetit. Një rëndësi të veçantë gjatë këtij aktiviteti iu dha edhe organizmit të seancave të informimit nëpër shkollat dhe vendosja e njoftimeve nëpër këndet e njoftimeve nëpër të gjitha shkollat nëntëvjeçare jo vetëm të qytetit, por edhe të fshatit. Vlen për t'u përmendur puna e mirë e të gjithë mësuesëve të vizatimit nëpër këto shkollat dhe e koordinatorit të projektit, z. Ermal Krasi. Punimet e bëra nga duart e vogla të fëmijëve u mblodhën dhe u ekspozuan në fillim në mjediset e Kryqit të Kuq dhe nga data 15 deri në 25, këto punime u ekspozuan në mjediset e bibliotekës "Vexhi Buharaja", kati i parë. Më pas një pjesë e punimeve do të afishohen në pavionin e fëmijëve të spitalit rajonal në Berat si dhe në qendrën e zhvillimit mendor.

Për fëmijët pjesëmarrës në këtë konkurs u ndanë këto çmimet: Çmin e parë, e meritoi nxënësi Erlin Musabelliu i shkollës jopublike "Irfan Ngjeçari".

Çmimin e dytë, nxënësja Nevila Muka e qendrës kulturore të fëmijëve.

Çmimin e tretë, nxënësi Martin Ethemaj.

U dhanë shumë çmime inkurajuese dhe fëmijët që morën këto çmime janë: Sindi Ormenaj, Oert Mahmutaj, Jolta Gura, Lorin Demoj, Faiken Idrizi, Franc Nallbani, Ergi Jahollari, Andrea Bojaxhiu.

Numri i punimeve të vendosura në ekspozitë ishte 245 vizatime nga të gjitha grupmoshat. Fëmijëve iu shpërndanë dhuratat simbolike dhe një çertifikatë. Tre punimet e vendeve të para do të paraqiten në konkursin kombëtar që do të zhvillohet në Tiranë nga dega e Kryqit të Kuq Shqipëtar. Kryqi i Kuq falënderon të gjithë fëmijët pjesëmarrës në këtë konkurs si dhe të gjithë ata që kontribuan në zhvillimin me sukses të këtij aktiviteti.

Monika Melëngu

U shtrua sofrë kristiane në Shëndëlli



Sofra e Shëndëlliut

Një evropian, zëvendës-president i UNESKOS, midis shumë të tjerave, ka theksuar: "Ky vend është i privilegjuar, sepse e ka përkëdhelur Perëndia". Kjo thënie shpirtërore është dëshmi e së vërtetës, trashëgimisë, si pjesë e kulturës në kujtesën e kohës.

Në kishën e Shën Ilias ose Shëndëlliut, e cila ndodhet mes kurorave të kodrave me ullinj, u shtrua në ditën e tretë të Pashkës, sofrë e bujarisë kristiane.

Këtë vit, kjo ditë e shënuar përkon me Shën Markun.

Liturgjia filloi në orën 18.00, por besimtarët ishin ngjitur më herët duke rregulluar vendet ku do të darkoheshin pas faljes.

Këtë liturgji e drejonte at Petraçi, i cili në prani të qindra besimtarëve të ardhur nga gjithë diogjeza kreu dhe litaninë me ikonën e Anastasit përqark, e cila shoqërohej nga një ansambël i besimtarëve me hymnin e ngjalljes.

Në këtë ditë, që në traditë njihet dita e shuarjes së qirinjve, ndihet atmosfera festive dhe e ndërgjegjësimit tek udhërrëfuesi i jetës, ndaj prania e tyre është dëshmi e formimit të besimit.

Lambadhet e ndezura dhe këngët e bukura, jo vetëm himnet fetare, por edhe ato të këngëve të bukura beratase, prania e fëmijëve, engjëjve të shpresës duke goditur vezën e kuqe, këtë simbol, e shtonin më shumë bukurinë, kur thoshin: "Krishti u ngjall-Vërtetë u ngjall"

Ja pse Beratin e kodikëve të Onufrit, Konstandinit e ka përkëdhelur Perëndia, sepse këtej kaloi dhe apostul Pavli një nga nxënësit e Krishtit. Këtu u martirizua Shën Kozmai dhe Shën Nikodhimi model të besimit. Le ta ruajmë e t'ia lëmë stafetë këtë trashëgimi brezave.

Sotiraq Mishaxhiu

Festa e shkronjave

Personeli mësimdhënës i shkollës 9-vjeçare "Thimi Tani" ka kohë që po lufton për cilësinë dhe punën e ka nisur me moton: "Ta fillojmë nga vetja".

Në vijim të shumë aktiviteteve në datën 04.05.06 në QKF u zhvillua dhe festa e shkronjave me një klasë të parë, festë që pati disa të veçanta që kanë vlerën e referimit.

Nxënësit ishin përgatitur mjaft mirë për t'i qëndisur shkronjat me këngë e vjersha duke përcjellë emocione e mbresa te pjesëmarrësit me aftësitë shprehëse dhe interpretuese. Duartrokitje të veçanta mori nxënësja Aleksandra Selani, e cila edhe pse me këmbë të thyer (hedhur në allçi) ulur në karrige dha shembull interpretimi me zë melodioz duke dashur më tepër shkronjat se shëndetin.

Në aktivitet ishin dhe mësuese pensioniste (Eminea, Andromaçi, Lefteria, Merjemja etj), të cilat dhanë mesazhin që, edhe pse në pension, për mësuesin shkolla është shtëpia e dytë.

Pjesëmarrës ishin prindër, nxënës të ftuar etj.

Shumë domethënëse ishte dhe pjesëmarrja e mësuesve të tjerë të shkollës për mesazhin që dhanë: "Të gjithë bashkë të vlerësojmë punën e njëri-tjetrit.

E, këto të veçanta janë me vlera për të gjithë.

Aktivitete të tjera na presin.

Drejtori i shkollës
Çerçiz Olldash

Nga Ymer Berati te Baftjar Kafexhiu një traditë e gjelbër

Kërkush nuk mund ta mohojë se Berati është një nga qytetet më të bukura në Shqipëri. Këto bukuri ia ka falur i madhi Zot ose mëma natyrë, do të thoshte një ateist. Kushdo që t'ia ketë faluar, dihet se dhe pa kujdesin dhe dorën e njeriut, këto bukuri do të kishin degraduar (siç kanë filluar disa prej tyre). Por, shqyrr që ka dhe njerëz, që nuk i lënë që të degradohen e humbasin vlerat e qytetit. Që nga lashtësia, qyteti i Beratit, është quajtur qyteti i trëndafilave. Përpos bukurive natyrore ku në mënyrë harmonike rrinë pranë e pranë toka, mali, qielli dhe uji ia shtojnë bukuritë dhe lulishtet e ndërtaura nga dora e njeriut. Berati, ndoshta ka lulishtet më të bukura në tërë vendin dhe kjo falë atyre që janë marrë me lulet. Njerëzit e apasionuar pas luleve i kanë lënë në breza trashëgimi njëri-tjetrit. Unë nuk e di se cilët kanë punuar lulishtarë në kohën kur u ngrit parku në hyrje të qytetit, i quajtur që në ndërtimin e tij "Parku i Dëshmorëve të Kombit". Kjo, për faktin se në atë park u ngrit një përmendore për këta heronj. Diktatura, që vlerësonte më shumë muzhikët sllavë, i dha emrin e diktatorit Stalin ku nuk përtoi i ngriti dhe një bust prej çimentoje. Nejse, të shkuara të harruara. Do pranuar se lulishtet brenda qytetit u përfituan nga prishja që iu bë dyqaneve në rrugën kryesore, megjithëse tek-tuk nxirrte syrin ndonjë parcelë e gjelbër dhe lulëzonte ndonjë lule. Një nga më të apasionuarit për lulet, padyshim ka qenë avokati Ymer Berati, të cilin diktatura, pasi e burgosi, i hoqi të drejtën e profesionit dhe e caktoi punëtor lulishteje! Ajo e bëri këtë për ta poshtëruar. Qe një njeri që vinte nga një familje e madhe aristokate, një njeri me shkollë të lartë, të merrej me dhera e me lule. Ata nuk e dinin se i kishin bërë nder jo vetëm atij, por në radhë të parë qytetit të Beratit që i vunë për të mbrojtur lulet e lulishtet, "doktorin" e luleve. Dhe një



sekretar i parë komunist, që kishte qenë ambasador në një shtet evropian ku lulet dhe lulishtet janë krenaria e tij, kur u prishën dyqanet dhe u ndërtaua rruga buzë lumit, urdhëroi që në dy anët e kësaj rruge të mbilleshin trëndafilat. Dhe u mbollën. Ajo rrugë, që sot kundërmon që prej 15 vjetësh era amoniak, do pranuar na pëlqen apo jo në darkë kur uleshin njerëzit në bordurat e saja, vinte era trëndafilat. Kanë kaluar kaq vjet dhe sot lulishteve i shërben një tjetër djali i një familje të dëgjuar e të respektuar, biri i një babai, që në dyqanin e tij nuk mungonin kurrë vazot me lule. Ashtu, siç nuk mungonin lulet e shumta në shtëpi dhe në ... veshin e të respektuarit Isuf Kafexhiu. E pra, nga dashuria për lulet, që iu kishte rrënjësuar që në familje, shkoi e studioi në shkollë të lartë dhe inxhinieri i talentuar Baftjar Kafexhiu. Do pranuar, se megjithëse ai i gjeti lulishtet të ngritura, ashtu siç do pranuar se paraqitjen dhe gjendjen e tyre i ka përmirësuar dukshëm. Lulishtja e "Dëshmorëve të Kombit" është përtërirë. Po ashtu dhe lulishtja në lagjen "Barrikada". Shumë e bukur u bë lulishtja e bibliotekës, e cila po mirëmbahet për mrekulli nga ndërmarrja që drejton Baftjar Kafexhiu. Po kështu një

rehabilitim ka në hyrje të qytetit, në parcelat anës rrugës, që vjen nga kombinati. Do pranuar nga të gjithë se lulishtja që duhet të jetë më e bukur (në fakt të gjitha duhet të jenë të bukura), duhet të jetë ajo e qendrës dhe është e tillë. Është një lulishte ku i shërbehet me kujdes. Por, nuk trajtohet me kujdes nga ata që lozin aty tërë ditën, apo rrinë e lexojnë gazetën. Jo rrallë ata dhe të tjerë gjejnë rrugën më të shkurtër për të dalë në rrugën kryesore duke shkelur mbi barin e parcelave të gjelbëra! E përse? Sepse, përtojnë të shkojnë, jo shumë, por vetëm maksimumi 10 metro më poshtë. Nuk duhet shpërblyer kështu puna e mundi i lulishtarëve. Kjo e ka një zgjidhje, roja i lulishtës të jetë i plotfuqishëm për të gjobitur cilindo që shkel mbi bar! Rregulli vihet me dhunë.

Kësaj lulishteje, këto ditë i është rinovuar një mjedis i vogël, por shumë i bukur dhe funksional. Në mes të saj një sipërfaqe e vogël ka ditë që ka filluar të shtrohet me zaje lumi (material i gjendur me shumicë dhe i fragmentuar nga ndërmarrjet e ndërtimit të inerteve. Ndërmarrja që drejtohet nga zoti Baftjar Kafexhiu, me punëtorët e saj, duke harxhuar vetëm çimento bëri të mundur rifreskimin e

kësaj sipërfaqeje që është bërë një kënd i bukur shlodhje. Shtrimi i rrugëve e rrugicave të lulishteve po të bëhet nga kjo ndërmarrje kushton me siguri nga 7-8 herë më pak se sa mund të kushtonte me tendera e me prokurime. A nuk do të ishte më e arsyeshme që ato pak fonde që mund të japë bashkia mund të rehabilitonin më shumë rrugë e rrugica e lulishte se sa po të bëjë tendera e më the e të thashë. Po t'i ishin dhënë kësaj ndërmarrjeje ato fonde që u dhanë në prag të zgjedhjeve, ju them me siguri që lulishtet tona do të ishin si të qindisura dhe ato janë bërë midis pallateve, do të kishin përfunduar e nuk do të ishin shtruar me asfalt, por me zaje, që kushton më lirë dhe janë më të bukura. Kur njeriu i hanë duart, kur njeriu e do punën dhe qytetin gjen forma dhe mënyra për ta ndihmuar e zburuar. Në këtë ndërmarrje punës i është gjetur njeriu. Ky është Baftjar Kafexhiu, që është këmbëngulës, këtë e kemi provuar kur ai nuk hoqi dorë nga mbjellja e rrepeve anës rrugës së Uznovës. "Baftjari" mbill, keqbërësit thyej. Ai mbill, ata thyej. Më kujtohet kur në një shkrim ai thoshte, ne do ta mobilojmë atë rrugë dhe sikur t'i shkulin të gjithë. Dhe ja, midis të keqes dhe të mirës, fitoi e mira. Ndaj

sot i themi të lumshin duart, o Baftjar Kafexhiu që bën dhe punë që nuk të takojnë. Madje i bën me forcat e tua, që di t'i kollondrisësh. Si mbyllje, me që jemi mbase dhe në kohën kur qytetet duhet të gjejnë vetë njeriun që duhet t'i drejtojnë për 4 vitet e ardhshme. A nuk është një kandidatë e shkëlqyer kjo e inxhinier Baftjar Kafexhiu që i plotëson tërë kërkesat që kanë qytetarët beratas? Qytetar

autokton beratas den-babaden. I ndershëm, i përkushtuar për punën që bën, njeri me fantazi e me kulturë, ashtu siç duhet të jetë një kryebashkiak i vërtetë, njeri që nuk e merr njeri prej dore e t'i thotë bëj këtë e bëj atë. Ju që e keni për detyrë mendohuni dhe jepni shans beratasve të votojnë për djalin e tyre të talentuar që e do Beratit.

Bujar Orizaj

Debat:

"Sa janë transparentë bashkia dhe këshilli bashkiak me qytetarët"

Më 4 maj 2006, në një nga mjediset e bashkisë Berat, u organizua nga drejtorja e marrëdhënieve publike dhe e burimeve njerëzore një debat me përfaqësues të shoqërisë civile me temë "Sa janë transparentë bashkia dhe këshilli bashkiak me qytetarët".

Pjesëmarrësit debatuan për masat që duhet të marrë bashkia për shmangien e zjarrit në lagjen Goricë, Kala, Përrua dhe gjetkë; për ndjekjen prej saj të problemeve të ndryshme që ka qyteti, si p.sh. për dëmtimin e kapakëve të pushtave, zhbllokimin e tyre, etj.; për masat që duhen marrë për pastrimin dhe thellimin e luginës së Osunit që të dalin në dritë këmbëzat Urës së Goricës ose të Urës së Varur; për problemin e heqjes urgjente të digës, si shkaktare e mbathjes së luginës së Osunit; për krijimin e një zyre adresash; për problemin e rritjes së kërkesave të bashkisë ndaj qeverisë për buxhetin që të mund të përballohen nevojat e mëdha që ka qyteti; për problemin e shmangies së ujërave në lagjen "Murat Çelepi" që vijnë si rrjedhojë e nivelit të ulët të terrenit; për problemin e kthimit në identitet të të gjitha rrugëve të dëmtuara nga Kesh-i; për vendosjen e tabelave për emërtimet e lagjeve, rrugëve, shesheve...

Një frymë të re solli në debat grupi i nxënësve të shkollës së mesme "Babë Dudë Karbunara", shoqëruar nga mësuesja Suzana Sinani. Midis problemeve që ata ngritën, veçojmë: krijimin e mundësive të zhvillimit të sporteve dimërore; zhvillimin e veprimtarive fizikurore-sportive e kulturore; krijimin e mjedisve për argëtim, që të shmanget vajtja e tyre vetëm nëpër pabet, rikthimin në identitet të kinemasë së qytetit; sistemimi i të rinjve në punë; ndërmarrjen e një studimi për evidencimin e të gjitha familjeve që me të vërtetë janë në nevojë dhe që duhet të marrin ndihmë sociale etj.

Z. Kadri Kuka, në emër të drejtorisë së marrëdhënieve publike dhe burimeve njerëzore, në mbyllje të debatit falënderoi pjesëmarrësit dhe u premtoi atyre se të gjitha problemet që u ngritën, do t'ua raportojë drejtorive përkatëse dhe hap pas hapi do të bëhet dhe informimi rreth zgjidhjes së tyre.

Jorgji Bendi

Karrige për Bar- Restorante

C
I
L
Ë
S
I



tel: 036220295



interalbanian

PREKNI TE ARDHMEN

Drejtor Ilir Qepa

ADRESA:

AGJENSIA E AUTOBUZAVE
PERBALLE XHAMISE SE PLUMBIT.

Përkujtohet dëshmori Aqif Karaj

Me rastin e 5 Majit, Ditës së Dëshmorëve të Atdheut, në shtëpinë e ushtarakëve Berat, u organizua veprimtaria letrare-përkujtimore: “Një jetë për jetën”, kushtuar dëshmorit xhener Aqif Karaj, rënë në krye të detyrës më 10 prill 1998, në repartin e Gjerovenit, gjatë çminimit të minave të mbetura që nga viti 1997.

Merrnin pjesë ushtarakë xhenerë, shokë e miq të dëshmorit, familjarë, nxënës të shkollës së mesme “Shyqyri Lakra” etj. Mungonin përfaqësuesit kryesorë të pushtetit vendor. Qarku përfaqësohej nga z. Ymer Kordha, kurse bashkia nga z. Kadri Kuka.

Kjo ceremoni nisi me rivarrimin i eshtrave të dëshmoritë në Varezat e Dëshmorëve të rrethit, shoqëruar edhe me breshëri armësh.

Koncerti-homazh për jetën e veprën e dëshmorit ishte ideuar nga mësuesi e shkrimtari Namik Selmani. Në të pati poezi për dëshmorin, një këngë kushtuar atij me muzikë të muzikantit Fatmir Këmbaci dhe me tekst të Namik Selmanit, titulluar “Lulja e kujtimit”, si dhe një ekspozitë fotografike me titull “Lartësia e një jete”. Koncerti-homazh u pasurua edhe ne fragmente nga libri i Besnik Alibalit, kushtuar sakrificave të armës së xhenios.

Fillimisht fjalën e mori ushtaraku Ferit Hoxha. Pas recitimit të poezisë “Xhenerët” nga një nxënëse e shkollës së mesme “Shyqyri Lakra”, në emër të këshillit të qarkut e mori fjalën z. Ymer Kordha. Më pas e morën fjalën ushtarakët, shokë të dëshmorit, Petrit, Ylli, Hekurani, Guri Velçani në emër të banorëve të fsjhatit Gjeroven, kryetari i Komitetit Kombëtar Antiminë me qendër në Durrës Besnik Alibali, i cili parashtroi në fjalën e tij aspekte interesonte nga jeta e dëshmorit, Orhan Frashëri në emër të veteranëve të luftës, Stavri Xhara, drejtori i shkollës “Shyryri Lakra”, etj.

Me shumë emocione u prit recitimi i poezisë kushtuar dëshmorit nga nipi i tij i quajtur edhe ky Aqif Karaj.

Në fund falënderuan edhe pjesëtarë të familjes. Për të pranishmit u shtrua edhe një drekë përkujtimore.

Lajmëtari

Një xhaketë e pluhurosur, e gjakosur dhe gati e copëtuar nga minat vdekjesjellëse të vitit 1997, në hyrje të sallës së madhe të shtëpisë së ushtarakëve Berat, ku po organizohej një veprimtari letrare-përkujtimore, tërhiqte vëmendjen e të gjithë brezave pjesëmarrës. Një relike që mund ta kishte një vend të dukshëm jo vetëm në një muze lokal apo kombëtar, por do të ishte një nga reliket më të rralla e më mbresëlënëse në çdo muze evropian kur është rasti për të treguar heroizmin e heshtur të xhenerëve, sakrificave të cilëve nuk njihet kufi kohorë e gjeografikë.

Shokët e dikurshëm të Dëshmorit të Atdheut Aqif Karaj, rënë në krye të detyrës më 10 prill 1998, në Gjeroven të Beratit, bashkë me dhimbjen njerëzore që shprehin për këtë humbje të parakohshme, i shprehin mirënjohjen familjes për këtë kujtim që do të zgjojë gjithmonë dallgët e mallit e të krenarisë që dikur patën një shok aq të mirë, kaq të aftë profesionalisht, kaq të dashur, e që... nuk jeton më.

Kjo xhaketë është një pjesë e Librit të Heroizmit që bëhet në emër të kombit.

... Atëherë ishte prill. Pranverë do të thoni ju. Lule do të kujtojë një tjetër. Jo. Jo... Ishte një shi i madh. Shi... Një dimër i vogël në mes të pranverës. Sikur parandiente një humbje shoku e këto litarë

piklash shiu që vinin nga mjegullat e Shpiragut, do të ktheheshin atë ditë si litarë lotësh nga të gjithë ata që do ta merrnin lajmin e pabesueshëm të vdekjes në krye të detyrës të shëfit të xhenios Aqif Karaj..

I lindur në Cërrik, me origjinë nga një familje e nderuar nga Kodër Bujarasi, Aqifi kishte marrë një status të përjetshëm bujarie për të gjithë ata që e kanë njohur nga afër. Në 30 vitet e punës së tij si ushtarak xhener ai do t'i provonte të gjithë sfidat që të jep ky profesion. Në galeritë e tuneleve ushtarake ai do të merrte lajmin e gëzuar të lindjes së dy djemve. Do të këshillohej aq sa mundej për të gjitha problemet që kishte familja.

I mallëngjyer dëgjonte nga larg zërin e ëmbël të Hatixhesë e më pas të djemve që rriteshin pa përkëdheljen e atij që dinte të përkëdhelte aq mirë. I duhej të shërbente në vise të tjera të largëta për të lumturuar të tjerë fëmijë nënash. Të dy receptorët nga vise të largëta, nga Burreli, provonin emocionet më të bukura e më të prekshme njerëzore...

Duart e tij të shkathta atë ditë, për herë të parë në jetë, vetëm për një çast që ishte aq fatal, do të dorëzoheshin para pabesisë që ka beteja me minat e fshehura që sjell gjithmonë një vdekje të paralajmëruar. Toka ishte mbuluar me bar pranveror. Ndoshta donte të mbyllte

plagët që hapi 1997-ta që ende nuk ishin mbyllur. Vdekja e tij do të mbyllte një karrierë 30-vjeçare shembullore në shërbim të xhenjos. Një jetë që u shërbente me plot bujari me qindra e mijëra jetëve të tjera anembanë Shqipërisë. Jo rrallë duke sakrifikuar. Jo rrallë duke qenë në prag të tragjedisë...

Po betimi i komandant Aqifit ishte e mbeti i shenjtë që kur u vu për herë të parë në rreshtin e ushtarakëve.

Shokët e tij të dikurshëm Përparim Saliq, Fitim Kumani, Muhamet Buxhaku e sidomos ish komandanti i bazës Kadri Sula, akoma nuk e besojnë se nuk e tyre aq të mirë, të qeshur e të papërtuar.

Më emocionoi edhe tregimi i shkrimtarit Vasil

Premçi për të. Vasili ka bërë një libër për dëshmorin xhener, kapitenin Panajot Haxhimihali me titull “Kapiteni që luante me vdekjen” Ai e njihte nga afër këtë njeri të mirë e të aftë. Madje e kishte patur edhe në shkollë në vitet kur studionte për këtë profesion, me të cilin do të lidhnin jetën. Mbase nuk do të jetë e largët dita kur edhe për major Aqif Karajn të botohet një libër më vete, që do të ishte një kurorë e thjeshtë nderimi për heroizmin e tij... Me plot respekt flet sot edhe Kryetari i Komitetit Kombëtar Antiminë Besnik Alibali që po ndihmon për propogandimin e heroizmit të dëshmorëve xhenerë në të gjithë vendin. E në shenjë nderimi e respekti komandanti Hamdi Alipaj, me detyrimin njerëzor dhe moral, ndihmon që ceremonia e

KUR KA MOTIVIM ...

(*Një konkurs dhe disa probleme*)

Për tre ditë me rradhë , në shkollën e mesme "Myrteza Kepi" në Kuçovë , nën kujdesin e drejtorit , z. Ferdinand Potoli , u organizua një konkurs enciklopedik interesant . Synimi i tij ishte gjallërimi i jetës së të rinjve në shkollë , përmes provimit të njohurive të marra jo vetëm në rrugë shkollore , por edhe me forma e mjete të tjera , të cilat të rinjve sot nuk u mungojnë . Gara për të parë se sa dimë dhe si mund ti reflektojmë ato që dimë , u organizua në tre paralele , me vitet e dyta , te tret dhe të katërta , secili paralel me përfaqësuesit e vet . Mësueja e pasionuar Majlinda Janku që u ngarkua nga drejtoria e shkollës për zhvillimin e konkursit , mendoj që pyetjet të ishin të karakterit të përgjithshëm , duke përfshirë fushat që tërheqin më shumë interesin e të rinjve , si muzika , arti skenik , piktura , letërsia , shkencat dhe arritjet e reja në këtë drejtim , nga gjeografia , historia , sporti etje . Konkursi u zhvillua me ekipe , por edhe individual , ku dolën klasat më të mira dhe njëkohësisht edhe individët më të mirë .

Veç gjallërimit të jetës në shkollë , në këtë veprimtari u vunë re edhe disa fenomene për të cilat dua të ndalem më poshtë .

Së pari , shumë nga mësuesit , të cilëve u kërkoi ndihmë ekipi organizues u treguan të gatshëm duke hartuar pyetje interesante , sipas fushave që ata zotëronin më mirë . Dhe këtu duhet theksuar se u përgatitën treqind e pesëdhjetë pyetje që përfshinin enciklopedinë "dua të di gjithçka" , në se mund ta titullojmë kështu , nga të cilat rreth treqind u shtruan në konkurim përballë tridhjetë e ca nxënësve .

Së dyti , interesi i konkuresve ishte për t'u lavdëruar . Ditët e para , kur u mor vesh se do kishte një konkurs enciklopedik dhe se do kishte përfaqsim individual dhe si klasë , filluan ethet e garës . Të rinjtë , vetzgjodhën ata shokë apo shoqe klase që

mendonin se do t'i përfaqsonin më denjësisht në konkurim . Jo vetm kaq , por midis tyre nisi dhe diskutimi se si mund të paraqiteshin



më mirë dhe dashje apo padashje , eliminuan dikë dhe përzgjedhën dikë që i bindi më shumë për njohuritë që zotëronin . U vunë re ethet e garës , të zakonshme këto për moshën e tyre , konsultime hamendësore së ç' mund të përfshihej në një tezë me dhjetë pyetje dhe cila do ishte përgjigja më e saktë .

Këtu dua të ndalem një çast , pasi shpesh ankohe mi se interesi i të rinjve , nuk është në lartësinë e duhur për shumë probleme që ne të rriturve na preokupojnë . Ankohe mi se " këta të rinjtë e sotëm , vetëm diskut dhe pubet njohin , se intersin për mësimet e kanë të dorës së dytë dhe se rrezikojnë për të ardhmen e tyre kështu siç ecin " etje . Në fakt , megjithëse është thjesht një konkurim pa asnjë stimul material , nuk ishin të interesuar vetëm konkurentët , por gati të gjithë nxënësit e klasës duke stimuluar sfidantët me pjesmarrje aktive e cila u la e lirë dhe në dëshirën e vet nxënësve . Diskutimet dhe debatet vijonin edhe pas konkurimit , ku shpesh edhe debatohej për jurinë , për pikët dhe për saktësinë e pyetjeve .

Së treti , dua të theksoj se pikërisht ,



Një çast nga ndjekja e konkursit në shkollën e mesme "M. Kepi"

Fotot
A. Refaeli

Nga takimi me shkrimtarë të qytetit me nxënës të shkollës së mesme "M. Kepi"

kur u zgjua interesi thelbësor për dijet dhe u gjet një mënyrë për ta zgjuar këtë interes , pamë se të rinjtë nuk paskëshin qënë aq indiferent sa na duken në pamje të parë . Madje pamë edhe prekje në sedër nga ata që mendonin se ishin përgjegjur saktë , pamë edhe reflektim nga grupet e mëpasshme . Vitet e tret u treguan më të kujdesshëm , dhe akoma më sërëlinj ata të viteve të katërta . Edhe sedra midis dy apo tre më të mirëve për çdo paralel u ngrit më lartë . Nxënës të viteve të treta si Rena Sado , Herla Praka , Esmeralda Liko apo Heërald Ruço , u dalluan për saktësi më të madhe dhe grumbulluan më shumë pikë së konkurentët e tjerë që ishin fare pranë tyre dhe diferenca bëhej vetëm me një ose dy pikë .

Një problem tjetër mendoj se është dhe preokupimi ynë si mësues për të ngacmuar tek nxënësi atë që e intereson më shumë , ose duke e ndërtuar në mënyrë të tillë kërkesën që tek ai të zgjohen ata elementë interesues për dijen në fushën konkrete . Sigurisht këtu nuk do të thotë

që mësuesi të gjejë çdo orë mësimore vetëm gjëra interesante për nxënësit dhe të mendoj vetëm për fantazinë e nxënësit , sepse do ishte ideale dhe do kërkonte që mësuesi të mos zhvillonte 5 apo 6 orë mësimore në ditë por vetëm dy ose tre . Ose do ta kishte të vështirë që të punonte gjithë kohën me këtë intensitet dhe mbase do linte pas dorë elemente të tjetër pedagogjikë apo përgjithsisht mësimorë .

Edhe një gjë tjetër del këtu , dhe me të drejtë; pse disa nxënës janë të interesuar vazhdimisht për të ditur gjithçka dhe shquhen mes shokëve apo shoqeve ,ndërsa pjesa dërmuese u dashka të stimulohet ndryshe dhe iu dashkan gjetur mënyra interesante etje , etje ? A nuk jnë të gjithë njësoj nxënësit për mësuein ? A nuk do dëmtonte interesin e nxënësve të mirë në se do preokupohej më shumë për ata që reflektojnë dobësi ? Mendoj se një mësues i mirë dhe vërtetë i interesuar për të dhënë sa më shumë dije dhe njohuri , di dhe gjen gjithmonë mënyra të reja për spjegim , për kontroll dijesh , lufton rutinën apo stimulon interesin e indiferentëve . A lodhet me ngarkesën orare të sotme ? Sigurisht lodhet dhe shumë madje . A i shpërblehet munda një mësuesi të tillë ? Në përgjithësi jo ! Dhe shkaqet janë të thjeshta ; Edhe në se do drejtori i shkollës ta stimuloi një mësues të tillë , nuk ka asnjë mundësi , veç ti përmendë ndonjëherë emrin , si dikur , nëpër raporte .

Së fundi menoj se nxënësit tanë kanë goxha aftësisht dhe dijet i zhvillojnë , veç duhen gjetur rrugët për ti zbuluar këto aftësi dhe talente , se pastaj ata lulëzojnë vetë .

FEJZI MURATI



Studio skulptori

Skulptori Nezir Ago është një nga artistët e njohur të portretit (skulpturë). Ndër veprat e tij më të rëndësishme krahas "Flautistes, janë edhe mjaft portrete njerëzish të thjeshtë deri te Konstandini i Madh i vendosur në kështjellën e Beratit.

Kohët e fundit skulptori Nezir Ago po punon për të realizuar portretin e dëshmorit të kombit Astrit Suli.

Astrit Suli u vra në Kosovë gjatë luftës midis UÇK dhe paramilitarëve serbë.

Bashkëluftëtarët e Astrit Sulit nga Kosova erdhën në qytetin e Beratit dhe porositën skulptorin për portretin e tij. Ky portret do të vendoset në një nga mjediset e qytetit të Kuçovës.

Lajmëtari

NXENESIT ME IDE NE VEMENDJEN E MESUESIT

Nje inteligjence, nje koke, ne te cilen mbijne idete eshte si nje toke ku mund te mbillen peme

Nxenes qe shkelqejne apo qe ndriçojnë?-

Nje dite, ndersa po bisedoja me nje inxhinier, te sukseshem ne profesion, (qe u perfshi ne tregun e punes ne Perendim pas 90-tes pa asnje lloj kompleksi) e po shkembeja mendime me te per konceptin e levizjen e re ne arsim per mesimdhënien me ne qender nxenesin, ai u shpreh: "Sa kohe na ka ikur kot e, ndoshta, vazhdon te na ike edhe sot. Une,-vazhdoi inxhinieri,- kam dy mbresa te pashlyeshme nga pervoja ime si nxenes: e para, kur ne nje lende, pasi mesuesi na dha nje detyre shtepie nga teksti, une i sugjerova se a mund te zhvilloja si detyre nje ide timen qe lidhej me mesimin,por jo konkretisht me tekstin, mesuesi heshti nje moment, me pa ngultas ne sy e me tha: "Po si te mos e zhvillosh?! Une kam 20 vjet qe e pres nje nxenes te tille! 20 vjet!" Ishte nje inkurajim dhe vleresim qe emocionalisht e perjetoj edhe sot. Ishte nje mesues qe vleresoi idene, sugjerimin krijues, te veçanten, intuiten time. Krejt ndryshe me ngjau nje vit me vone me nje tjetër mesues, po i se njejtës lende, kur, ne nje situatë te ngjashme, m'u drejtua gati si me hakerrim: "Shiko librin e nuk ka ç' te duhen ato!" Pra, dy qendrime te ndryshme, krejt te kunderta, por qe ne kontekstin e nje kohe te caktuar, mjerisht, ai qe vleresohej si model ishte mesuesi i qendrimit te dyte!

Ajo qe dikur paraqitej si spontane e pranohej rralle, sot kerkohet si nje gje elementare, normale, si pjese e natyrshme e te nxenit krijues te nxenesve.

Por, midis asaj qe kerkohet dhe asaj qe gjendet ka nje hapësire mjaft te madhe, ka nje distance, shkurtimi i se ciles arrihet ne ate mase qe fitohen koncepte te reja ,arrihet kuptimi i thelle per domosdoshmerine e ndryshimit dhe motivimi per te realizuar kete ndryshim. Tani eshte nxenesi qe e prët, e kerkon nje mesues dinamik, te zhdervjellet, te afte ne perdorimin e teknikave te reja ne procesin mesimor, ne zhvillimin e praktikave te reja te te nxenit, ku nxenesi ve ne veprim jo thjesht mekanizmin e kujteses, te kujtuarit, por instrumentet e te menduarit.

Sot, "Mesimdhënien me ne qender nxenesin" shtrohet para nesh si problem, si sfide dhe si imperativ.

Pse si problem?

Sepse veçorite e mesimdhënies me ne qender nxenesin kerkojne qe mesuesi te ndryshoje pozicionin dhe funksionet ne kete proces, qe jane te ndryshme nga mesimdhënien tradicionale.

Pse si sfide?

Sepse ndryshimi i vertete nuk eshte i lehte, sepse realizimi tij eshte i lidhur, i ndërvuar dhe i percaktuar edhe nga nje sere kushtesh, permbushja e te cileve varet edhe nga faktore jashteshkolllore.

Pse si imperativ?

Sepse rrethanat, koha ne te cilen jetojme dhe progresi ne boten e sotme



Simon Vrusho

imponojne permbushjen e standardeve te larta, pa te cilat do te shnderrohemi ne viktima te mjera te paafesise sone dhe mentaliteteve anakronike qe ne thelb jane regresive; ndonese te dala kohe e boje, ato jane ende ne perdorim sot e gjithe ditën.

Mesimdhënien dhe vleresimin tradicional kane arritur ne ate pike qe nuk mund te kaperdihen dot me. Fiktiviteti dhe ciptesia jane perhapur ne te gjithe nivelet e nxenesve. Jane ngjitur kaq lart sa te kujton thenien e njohur se jemi nje shoqeri qe vuajme me shume per cipe sesa per rrenje.

Ne çdo shkolle gjen nje table nderi me nxenesit me te dalluar. Kur pyet se perse jane dalluar keta nxenes, bashkebiseduesi te sheh si me çudi per pyetjen e bere, se i duket pa kuptim, dhe kur kembengul, ai te pergjigjet se keta jane krenaria e shkolles, mburrja e saj, se jane te shkelqyer ne mesime, se ta thone mesimin si ne liber, se i kane pergjigjet uje etj. Po, kjo eshte e vertete, por ne nje kuptim tjetër: pergjigjet e tyre kane shume uje. Keshtu vleresojme riprodhimin mekanik, permendesh te tekstit, por kjo, siç dihet, eshte tregues i nivelit me te ulet te te menduarit. A do ta pranonte kush diçtoren "Te dalluar ne kujtesen mekanike?" apo "Te shkelqyer ne nivelin me te ulet te te menduarit?", apo "Krenaria e shkolles, por pa ide?", apo "Te paret ne mesime, por te fundit ne intuitive"? Sigurisht askush, por faktikisht jo vetem i kemi pranuar, por edhe i kemi kthyer ne etalone me nje doze te rende pavartetësie brenda.

Inflacioni i te shkelqyerve tane eshte mjaft i larte. Mjaft nga te shkelqyerit e 9-vjeçares bien ne te mesmen, mjaft nga te shkelqyerit e te mesmes bien ne te larten dhe mjaft nga te shkelqyerit e se lartes bien kur dalin ne jete.

Pse bien keta te shkelqyer? Sepse

ata kane mesuar, por realisht nuk kane nxene, sepse te nxenit eshte atribut i te menduarit dhe sa me i thelle, me krijues te jete te nxenit, aq me i larte eshte niveli i te menduarit, i cili percakton zhvillimin e inteligjences. Inteligjenca nenkupton aftesi krijuese, mendim kritik, argumentim, ide, pavaresi ne te vepruar. Ne kete veshtrim mund te thuhet se kujtesa shkelqen, por te menduarit ndriçon. Ai qe vertet ka nxene eshte i pergatitur te perballoje problemet qe dalin ne jete, di te orientohet e te gjeje zgjidhje ne situatë te panjohura me pare, sepse ai qe zhvillon mendimin krijues ne shkolle eshte i afte te krijojë a te shfrytëzojë shanset e reja qe i ofrohen. Jeta verteton se ata qe ndriçojnë jane me rezultative se ata qe shkelqejne.

Nxenesit qe shfaqin nje lloj intuitive, qe kane ndjesi per risi, qe u ben pershtypje diçka, brenda pervojes se vet, jane te prirur per ide, bejne sugjerime, shtrojne pyetje dhe a nuk sjell

apati shperfillja apo injorimi i ketyre shenjave kuptimplote? Keto shfaqje, keto shkendija inteligjence duhen kapur e vleresuar ne bashkebisedimin e nderveprimin mesues-nxenes e nxenes-nxenes. Nje pyetje nxenesi qe lind nga reflektimi aktiv ndaj nje teme, objekti, meditimi a trilli kerkon vemendje te veçante nga mesuesi per kete moment, kerkon vleresim, ate nderveprim pa te cilin te nxenit nuk do te rezultojë efektiv, nxenesi nuk do te perftojë ide, koncepte, aftesi analizuese, seleksionuese e argumentuese. Mesuesi tradicional, shpjegues tipik, mekanik, eshte edhe nje pyetes klasik, kurse nxenesi nje pergjigjedhënes i tille ne nje ore mesimi ku etapat jane ndare si me thike. Mesues te tille, lene pak ose aspak hapësire per te menduarit kritik, krijues qe u zhvillon nxenesve arsyetimin, aftesine per te mprehur argumente, pergatitjen per te mbrojtur idete. Shume syresh nuk do ta braktisin lehte komoditetin e rutines tradicionale; madje pasivitetin e nxenesve me te cilin jane mesuar ata kane prirjen ta quajne rregull, disipline; apatine ta quajne vemendje, kurse merzine e nxenesve e lidhin me veshtiresine e lendes. Shfaqjen e ideve e quajne dalje nga tema dhe nuk vleresojne se nje inteligjence, nje koke, ne te cilen mbijne idete eshte si nje toke ku mund te mbillen peme.

Ndryshimi qe kerkohet per nje mesimdhënien me ne qender nxenesin ka koston e vet ne kohe, ne energji e ne perkushtim. Rendesi ka te ecet ne kete rrugë, pavaresisht se ne vend te realizimeve do te na mbijne problemet, sepse zgjidhja e tyre do te na tregojë se sa probleme kemi zgjidhur, kaq hapa kemi ecur perpara. Ne kete veshtrim mund te themi se mesimdhënien me ne qender nxenesin, ate qe deri tani e kemi quajtur dhe realizuar si proces mesimor, duhet ta shnderrojme ne proces nxenesor.

Simon Vrusho

(Diskutim ne konferencen pedagogjike "Mesuesi dhe sfida per ndryshim")

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I QARKUT BERAT

NJOFTIM

Këshilli i qarkut Berat, në cilësinë e Investitorit, për objektet e arsimit parauniversitar dhe objektet e shërbimit shëndetësor parësor, kërkon specialistë për Mbikqyrje dhe Kolaudim të investimeve të planifikuara për vitin 2006.

Specialistët e interesuar të paraqesin në këshillin e qarkut dokumentat e mëposhtme:

1. Liçensën profesionale për Mbikqyrje ose Kolaudim punimesh ndërtimi.
2. Çertifikatën e regjistrimit në organet tatimore.

Dokumentat e mësipërme të sillen brenda datës 05.05.2006.

Këshilli i qarkut Berat
Pelivan Shatri

Zakonet gjithmonë kanë qenë më të forta se ligjet. Ato mbartin brenda vetes së tyre respektin e shenjtë të shumë brezave të mëparshëm.

Koha ka provuar se as forca e as dëshira e mirë nuk mund t'i ndryshojnë ato. Pa dashjen e saj shoqëria njerëzore i ka kalcifikuar në ndërgjegjen njerëzore të saj dhe është e pazonja për t'i ndryshuar me një urdhër nga lart. Janë tepër domethënëse shprehjet: E kanë zakon, e kërkon zakoni, nuk e lejon zakoni, ne kemi zakonet tona, ata të tyre, e kërkon zakoni, etj.

Shanua ngeli nuse e re e ve. Burri i vdiq nga një infarkt akut. Ishte tepër e bukur dhe shumë e re. Njëzet e pesë vjeç. Gjithë fshati thoshte fjalët më të mira për të. Bënte punët e burrave dhe të grave. Kishte një djalë dy vjeç e gjysmë. Mbasi kishte kaluar disa kohë, një mbrëmje i vjehrra në prani të të gjithë familjes, i tha:

- Çdo të bësh me jetën tënde tani e tutje?
- Kam vendosur të lidh jetën me djalin tim. Asgjë nuk do të më ndalojë që jetën time ta vë në shërbim të këtij djali!
- Paç uratën moj bijë. Mendohu mirë se të presin vështirësi të mëdha. Je shumë e re dhe tepër e bukur për të bërë këtë sakrificë.
- Ne do të të duam si çupën tonë,- tha vjehrra.
- Po të na turpërosh ne do të zhdukim nga faqja e dheut,- i tha i kunati.

Ajo asnjëherë s' e ka dashur atë. E ndiente që ai ishte njeri i keq, prandaj edhe i ruhej.

I kishte kushtet për të bërë një jetë të qetë. Të rritej djali, pa shohim e bëjmë pastaj. Ishte rritur në qytet, por u përshtat shumë shpejt me jetën e fshatit. Ajo e adhuronte të shoqin, prandaj dhe sakrifiko për të.

Ishte verë. Vapa të zinte frymën. Për t' u freskuar ajo linte të hapur çdo natë dritaren e dhomës. S' kishte frikë nga asgjë...

Punët e shtëpisë dhe ato të fushës e lodhnin shumë, prandaj ishte e këputur kur binte për të fjetur. E kunata kishte shkuar te njerëzit e saj.

- Jam unë këtu, mos ki merak për shtëpinë,- i tha Shanua të kunatës.

Zakonisht flinte shpejt nga lodhja. Mbasi u tha "natën e mirë" të gjithëve, shkoi për të fjetur. Gjumi e zuri menjëherë. Dritaren e harroi hapur. Në mes të natës ndjeu se dikush po e prekte në trup duke e përkëdhelur plot pasion. Ajo dëgjoi sipër saj gulçimën e një burri që përpiquej për ta shtirë në dorë. Deshi të bërtiste, por ai i zuri gojën me dorë. Në fillim nga errësira ajo nuk u njohu.

- Të lutem mos ma bëj këtë turp. Unë të kam vëlla. Lëshomë se do të bërtas.

- Dëgjo,- i tha ai,- po hape gojën unë ty dhe djalin do t'ju mbysh në lumë. Ti do të bëhesh imja. Unë gjithmonë të kam dëshiruar. Askush s'ka për ta marrë vesh. E përlau si një kafshë, ishte tepër i fuqishëm për forcën e një femre. Poshtërsia u krye dhe ajo ngeli tepër e ofenduar. Mëngjesi e zuri duke qarë. Ç'të bënte? Me poshtërsinë e tij ai njeri bënte çdo gjë. Për vete nuk i vinte keq, por djali i hante kokën...

Perversiteti i të kunatit vazhdoi gjatë e do të vazhdonte deri sa erdhi një ditë që dha rezultatet e veta. Ajo ngeli me barrë.

- Po tani çdo të bëjmë?
- Shko mbytu në lumë!
- Kaq i poshtër je? Ti më zhyte në këtë llum dhe tani tërhiqesh? O Zot, sa i pashpirt qënke. Jeta është stuhi, në një çast ose në një tjetër copëtohesh nëpër shkëmbinj...

E mori dhe e fshehu djalin te disa kushërinj të largët.
- Në qoftë se sonte nuk zhdukesh, nesër mbrëma ty dha djalin do t' u mbysh në lumë.

Ku të shkonte? Ajo s' kishte asnjëri që ta ndihmonte. Mjerë ajo!

Në mëngjes si zakonisht e vjehrra shkoi për ta ngritur se do të milte lopën. Nuk e gjeti në dhomë. E kërkoi gjithandej, por s' e gjeti kurkund.

- Burrë, ngrehu se na ka ikur nusja! Djali po fle mirë e bukur. Në dhomën e saj gjetën një letër:

"Jam e ndershme. Turpi është juaji. Djalin po jua u lë. Nuk e dua më jetën, prandaj po shkoj të mbytem. Mallkuar qoftë kjo shtëpi!"

- Si e shpjegon ti këtë. Mos ke bërë ndonjë poshtërsi se e di që je qen?

- Ç'thuhet baba. Ajo kishte filluar ta luante bishtin. Ka ikur me ndonjë.

- Po letra? Për ç' turp flet ajo? Po të jetë ajo që thua ti, pse do të mbytet?

Lajmi mori dhenë dhe fshati thurri lloj-lloj historirash. Hajde mbyll gojët e botës. Djali kërkonte të emën. Ai ishte një dhimbje më vete.

Për Shanon s' kishte rrugë tjetër veç largimit. Kështu shpëtonte i biri.

Nën një depresion të madh mendor, ajo u nis drejt të panjohurës.

Ec e ec e shkatërruar nga të gjitha anët, kur dëgjoi zhurmën e një lumi në këmbët e saj. Kishte qëndruar buzë një shkëmbi ku poshtë saj ndihesh uji që ecte me rrëmbim. Nuk ishte në gjendje të kontrollonte veprimet e saj. U hodh me bindjen se aty poshtë e priste vdekja. Zhurmën e atij lumi dhe errësirën e asaj nate e prishi klithma e Shanos që ndofta në çastin e fundit u bë pishman

për aktin që kreu.

Lumi vendosi për fatin e saj. Rrobat e trupit dhe boçja që kishte marrë e ndihmuan sadopak. Mbas shumë peripecish ujërat e nxorën në breg pa ndjenja dhe të mbytur në gjak. Kishte humbur fëmijën që kishte në bark. Sidoqoftë ndiheshin rënkimet e saja.

Jetëgjati nuk bëhet jetëshkurtër.
Babai i teqesë ishte ngritur shumë shpejt për të shkuar në pazar.

Kur po bëhesh gati për të hedhur vaun, dëgjoi një rënkim njeriu që vinte nga lumi. Mbajti vesh dhe me mushkën prej dore shkoi drejt rënkimit.

Dalloi trupin e një njeriu të shtrirë në zallin e lumit. U ul

Edhe gëzimi vret

"Për çdo të keqe ka dy gjëra që të ngushëllojnë: koha dhe heshtja",

A. Dyma



dhe me aq sa e lejote errësira dalloj që ishte një femër. Me gjithë moshën e madhe që kishte, u vu në punë. Ai e dinte mirë se ç' duhet bërë në të tilla raste. I hoqi rrobat e njoma dhe me xhyben e tij e mbuloi.

Hoqi nga samari i mushkës batanijen dhe përsëri e mbështolli mirë e mirë dhe e lidhi me litarë në formë tubi. Me atë fuqi që kishte e ngriti dhe e hodhi në mushkë. Ajo në atë çast nxorri gjithë atë ujë nga stomaku dhe rënkoj.

- Mos u mërzit, bijë, do të shpëtosh, vetëm rrezisto edhe pak. Nxitoi drejt teqesë që nuk ishte shumë larg. Donte të mbërrinte aty pa ardhur mëngjesi. Kurioziteti i të tjerëve e bezdiste.

Mbërriti mirë. Ajo ishte gjallë. Thirrri një grua plakë që shërbente në teqe, ndërsa dervishin e nisi për te doktori që ndodhej poshtë në fshat.

E porositi që të ishte kyç.

Kur mbërriti doktori, mëngjesi kishte ardhur me gjithë bukurinë e tij. Babai po e priste shumë i shqetësuar. Menjëherë e çoi tek ajo. Plaka kishte bërë një punë të mirë për pastrimin e saj, kështu që doktori e gjeti të rregulluar. Ai bëri gjithçka që duhej, ishte specialist i zoti.

Kujdesi i tepërt, klima e mirë dhe mosha e saj e re bënë që të dukeshin shenjat e para të përmirësimit. Mbas një lëngimi të gjatë ajo doli nga koma.

- Ku jam?

- Midis miqsh, qetësohu. Duhet të hash mirë që të marrësh veten. Këtu nuk mungon asgjë. Unë jam doktori që do të shëroj, ndërsa ky është babai i teqesë që të shpëtoi jetën. Ai të do si vajzën e tij. Fli tani.

Ajo ishte shumë e dobësuar. Nuk e kishte marrë veten. Kaluan disa javë. U ngrit në këmbë. Nën kujdesin e doktorit dhe të plakës, ajo filloi që të ecë. Brenda një kohe të shkrutër e mori veten plotësisht. Natyra bën mrekullira. Ajo u bë pjesë e teqesë duke e mbushur atë me harenë e moshës së saj. Babai i gëzohej sikur të ishte vajza e tij. Ajo i zvogëlonte peshën e viteve që i rëndonin mbi supë.

Doktori vinte çdo ditë dhe Shanua duke e ditur orën, dilte e priste shumë larg teqesë. Ata ktheheshin të zënë prej dore duke

biseduar plot përzemërsi. Babai mrekullohej duke i parë ashtu. "Do Zoti, doktori është djali i mirë. Sidoqoftë unë duhet të jem në ruajtje për çupën. Do bisedoj me të se çfarë qëllimi ka. Djemve të kasabasë edhe s' duhet besuar shumë. T'ia lëmë kohës..."

- Ç' mendim ke për Shanon?
- Baba, unë e dua atë. Dëshira ime është ta kem grua, nuk di në do të pranojë!

- U bëftë emri i Zotit. Ma lërë mua këtë punë.
Ngjarjet u rrokullisën me të shpejtë. Doktori shkoi në Shkodër, mori nënën dhe erdhi. E prezantoi me Shanon si nusen e tij. Ajo dha bekimin e saj.

U bë një dasmë simbolike aty në teqe. Mbas një viti u largua përgjithmonë për në Shkodër. E vjehrra i vdiq shpejt. I erdhi shumë keq për të se e donin njëra-tjetrën.

Bashkë kaluan një jetë të lumtur. Nga martesë erdhën dy vajza. Njëra më e bukur se tjetra. E madhja e martuar në Tiranë. E vogla vazhdon shkollën.

Ka dy vjet që doktori ka vdekur dhe ajo jeton me vajzën e vogël. Vdekja e të shoqit e rrëzoi shumë si fizikisht ashtu dhe moralisht. Plakja i erdhi para kohe. Hallet të plakën. Ato akoma nuk kanë mbaruar për të...

Një ditë po kthehej e ngarkuar nga pazari. Edhe fuqitë po e linin.

- Nënë, më lër të të ndihmojë!
- Paç uratat, more bir i nënës.

Ishte një ushtar që kërkonte ta ndihmonte. Ushtari e shoqëroi deri në shtëpi. Ajo e futi brenda dhe e qerasi me gjithë të mirat. Urimet e saja nuk mbaronin. Ajo po e shikonte me shumë vëmendje: "Me kë më shëmbëllen ky djalë, ku i kam parë këto tipare?" Ai u ngrit për të ikur, megjithëse ajo po i lutej që të qëndronte për drekë.

- Do të jetë nder për mua, por mos u bezdisni. Unë jam jetim, kështu që kam shumë mall për ngrohtësinë familjare. Qysh sa u pashë ju më tërheqët si kur të ishit nëna ime. Nga gëzimi po flas budallallëqe. Mirë u pafshim.

Të dielën ai erdhi për drekë. Kishte prurë një kartë me mollë. Gëzimi i Shanos ishte i madh kur e pa që po vinte. E prezantoi me vajzën e vogël. Ata u miqësuan shumë shpejt. Ç'bën forca e gjakut.

Mbas buke ai rrëfeu historinë e tij. Ishte nga Pe... Babai e kishte lënë dy vjeç, kishte vdekur nga zemra. Për nënën nuk donte të fliste. Ka qenë një grua e keqe, që mbasi bëri një turp të madh, më braktisi mua dhe mori rrugët. Thonë që u mbyt në lumë, por trupi i saj kurrë nuk u gjet.

Asaj i ra të fikët. Të dy fëmijët bënë çmos për ta përmendur. Erdhi mjeku. I bëri mjekimin e çastit dhe ajo u përmend.

- Qëndroni në qetësi. S' duhet të emocionoheni nga ato që dëgjoni, se është me rrezik për ju,- i tha doktori.

- Më bënë përshtypje fjalët e tua. Nuk ka në botë nënë të keqe. Mos e gjykoni aq keq atë, se kurrë e kurrë një nënë nuk braktis djalin e saj dy vjeç. Ka shumë enigma në atë që më treguat, mendohuni para se të përcmoni nënën.

Kaluan disa ditë që ai s'po dukej. Ajo u bë merak. Çdo gjë për të ishte e qartë se kush ishte ky djalë. Me orë të tëra rrinte duke falënderuar Zotin.

- Do të iki me leje në shtëpi. Kam menduar gjatë për ato që më thatë ju. I vetmi që do të më rrëfejë të vërtetën do të jetë xhaxhai im, megjithëse ai nuk më ka dashur kurrë. Do ta detyroj, qoftë edhe me zor që të më thotë të vërtetën.

Mbas 15 ditëve ai u kthye nga leja plot gëzim.

-Nënë, ti kishte të drejtë. E detyrova xhaxhanë duke i vënë thikën në fytyrë që të më thoshte të vërtetën dhe ai ma tregoi gjithë poshtërsinë që i kishte bërë mamasës sime. Mblodha farefisnin dhe e detyrova atë të thotë para gruas, fëmijëve dhe gjithë të tjerëve çfarë krimi kishte bërë. Të gjithë e pështytën në surrat duke e dëbuar nga fshati me ceremoni.

E kishte marrë hakun si për vete edhe për nënën...

- Tani dua ta takoj mamanë time dhe ta rrok në qafë për të mos u ndarë kurrë nga ajo. Ah, mama, sa të dua! Edhe në fund të botës të kesh shkuar, unë do të të gjej.

Të dy po qanin me lot gëzimi.

- Dëgjo mirë, brenda 10 ditëve unë do ta gjej mamanë tënde dhe do ta sjell këtu në shtëpinë time. Unë e di ku është ajo!

U ndanë për t' u takuar atë datë që tha ajo. E bëri këtë që ai të qetësohej. Erdhi ajo ditë. Ishte e diel. Ai kishte blerë një tufë të madhe me lule.

- Erdhi mamaja? Sa po më rreh zemra!

- Po ka ardhur. Po shkoj ta marr se ajo mezi po pret të të përqafojë.

Kaluan disa minuta. U hap dera. Ai shtangu në vend. Hyri Shanua krahëhapur.

- Unë jam nëna jote, bir.

Ai u ngrit për të vrapuar tek ajo, por s' mundi. Ra përtokë pa ndjenja. Kur ajo u afrua dhe e mori në krahët e saj, ai kishte mbaruar.

- I ka rënë infarkt në zemër,- tha doktori.

- Tani që të gjeta, të humba përgjithmonë. Për çfarë më duhet jeta tani?!

Pershendetje!

Si jeni me shendet, vete dhe familjarisht?

Uroj te jeni mire.

Para ca ditesh une komunikova me Toshin nepermjet nje e-maili ku i shkruaja se kisha nje ngjarje personale. Ne pergjigje Toshi veç te tjerash me thoshte "presim ndonje shkrim nga ty per gazeten" Por meqe, siç edhe e dini, mua me jepet te shkruaj per probleme aktuale dhe meqenese une nuk mund ta perceptoj saktesisht aktualitetin aty per shkak te largesise, nuk mendoj se mund te "çalltis" ndonje gje te hajrit duke shkruar prej ketu.

Megjithate, une vendosa t'ju sjell hyrjen (esene) time, fituese ne konkursin per te cilin i fola Toshit. Eseja eshte e thjeshte (ju e merrni me mend, behet fjale per shkrim ne anglisht), por mendoj se edhe ashtu ajo mund te perçoje nje mesazh te lexuesi. E kam perkthyer thuasje pa asnje ndryshim ne shqip. Si do qe te jete, eshte ne doren tuaj te vendosni. Bashkangjitur i keni te dyja variantet. Mos harroni, origjinali eshte varianti ne Anglisht.

Tani diçka rreth Konkursit:

Ne kuader te integritimit te studenteve te huaj ne jeten kulturore te Wisconsin, gazeta promovuese "Çelesi" (The Key) e Milwaukee, ne bashkepunim me te gjitha Kolegjet dhe Librarite Publike te shtetit Wisconsin organizojne konkursin e pervitshem me titull "Readers as Writers" Ne edicionin e ketij viti moren pjese mbi 1000 pjesmarres, (faza paraeliminatore), ndersa ne fazen finale ishin rreth 400 hyrje. Nder to u shpallen 92 hyrje fituese. (Mund t'i gjeni ne adresen www.keynews.org Go to the winners list) Si tradite, te gjitha hyrjet fituese permblidhen ne nje liber qe arshivohet ne librarite dhe kolegjet pjesemarrrese ne konkurs. Ky liber perdoret ne vitet pasardhes si tekst mesimor per studentet e Anglishtes. Ndersa gazeta publikon ne faqet e saj 12 hyrje te zgjedhura nga hyrjet fituese. Ky konkurs eshte evenimenti me i rendesishem kulturor per studentet e huaj qe studiojne anglisht. Dje te gjitha fituesit ishin te ftuar ne nje party te organizuar prej tyre ne nje ambient te Librarise Publike te Milwaukee. Ishte nje mbremje e paharruar per mua. Te gjitha fituesve iu shpernda libri me hyrjet fituese te vitit 2006 dhe çertifikata e fituesit. Autoret e dymbedhete hyrjeve me te mira iu dhurua nga nje liber. Hyrja ime ishte nder to dhe mua me dhuruan "For whom the bell tolls" (Per ke bie kembana) te Heminguej.

Duke ju uruar gjithte te mirat.

Ali Lybeshari

Faleminderit SHBA!

I dashur Leutrim!

Shpresoj qe ju dhe familja juaj te jeni mire. Ti po rritesh tani, por une e di qe ti e ndien shume mungesen e babit tend, ashtu siç di se askush nuk mund te ta zvendesoje ate. Ti kurre nuk e njohe babin tend dhe as nuk do ta njohesh ate ndonjehere. Keshtu ishte shkruar fati yt! E di, ti nuk ke as varr per babin tend ku mund te çosh nje buqete me lule. Por hidhi ca lule ne lumenjte e Kosoves. Ata jane te paster tashme....

Ne Shkurt 1999, Sllobodan Milosheviç filloi te ashtuqajturin "Pastrim Etnik" te Kosoves. Me shume se nje milione shqiptare u perzune nga shtepite e tyre dhe u vendosen ne Shqiperi, Maqedoni etj. Me kujtohet dita e pare e mbërritjes se kosovareve ne qytetin tim te Beratit. Ishte mars dhe binte shi papushim. Autobusat me te cilet ata udhetonin arriten rreth ores 9:00 te mbremjes. Pothuajse gjithte qyteti kishte dale t'i priste ata. Kosovaret zbrisnin nga autobuset ndersa qytetaret beratas i merrnin ata ne shtepite e tyre. Une mora dy persona: nje burre te moshuar, Z. Rraci dhe nipin e tij 16 vjeçar, Endritin. Edhe pse ishin te dermruar nga lodhja, ata nuk mund te flinin. Ishin shume te tronditur, sepse nuk dinin asgje rreth familjareve te tyre. Ndersa kishin qene duke ecur drejt kufirit te Kosoves me Shqiperine, ushtaret serbe i kishin shperndare ne disa grupe.

Te neserem une anonçova ne televizionin publik qe z. Rraci dhe nipi i tij gjendeshin ne Berat dhe se ata donin te gjenin familjaret e tyre. Diten e dyte, Znj. Rraci, gruaja e tij, i telefonoi atij nga Tepelena, nje qytet ne Jug te vendit. Ajo ishte vendosur atje se bashku me nenen e Endritit. Diten tjeter, nusja e djalit, Bahrija, i telefonoi z. Rraci nga nje fshat i Durrës (qytet ne perendim te vendit), qe gjendet buze Adriatikut. Ajo ishte vendosur ne nje familje se bashku me djalin e saj gjashte muajsh, Leutrimin. Pese dite me vone, Teuta, mbesa e Z. Rraci i telefonoi atij nga Kruja. Ajo kishte mbërritur atje me nenen, vellanë dhe motren e saj. Nje jave pas mbërritjes se z. Rraci ne shtepine time, ne u beme 15 njerez. Por edhe pas kesaj familjet Rraci nuk ishin te



qeta. Ne sejcilen familje mungonte nje burre.

Zonjes dhe zotit Rraci u mungonte djali, mbesave dhe niperve te tij u mungonte babai. Ditet kalonin ndersa ata prisnin per te tjera telefonata. Por askush nuk telefonoi perseri. Rreth nje muaj me vone, ndersa te gjithte se bashku po shihnin televizionin, nje shenim me titra terhoqi vemendjen e tyre: Tridhjetete e kater burra ishin vrare nga paraushtaraket serbe ne nje fshat afer qytetit te tyre ne Kosove. Ata filluan te qanin. Pak me vone u anonçuan emrat e te vrareve. S' me mbeti tjeter veç t'u bashkoj dhimbjes se tyre dhimbjen time. Emrat e te tre burrave qe mungonin ishin ne ate anonçim te kobshem.....

Shume prej amerikaneve nuk i aprovojne vendimet e Presidentit te SHBA-se kur ky vendos te dergoje trupa ushtarake ne vende te tjera. Une i kuptoj ata. Ata nuk duan qe ushtaret amerikane te vdesin. Por une vleresoj vendimin e Klintonit per te luftuar ne Kosove. Ai eshte nje hero i madh per te gjithte shqiptaret. Ai fitoi luften dhe realizoi pavaresine e Kosoves. Dhe ushtria e SHBA-se nuk humbi asnje ushtar ne kete lufte.

Faleminderit, Amerike! Faleminderit, Z. Klinton!

Ali Lybeshari
Kolegji Teknik i Milwaukee-it
Oak Creek-Milwaukee, USA



Qejfmbetja e një "poeti"

Kur po merresha me përgatitjen e numrit të ri të gazetës "Lajmëtari" së bashku me Anxhelën, hyn në redaksi një i njohuri im që ka botuar disa vëllime me poezi. Mendova se ishte i interesuar për botimin e dy shkrimeve që kishte dorëzuar.

"Shkrimet nuk i kemi përgatitur për botim në këtë numër", iu drejtova.

Po ai e kishte patur hallin gjetkë.

"Ç'është një veprimtari që zhvillohet në Kala?"

"Një veprimtari poetike", i përgjigjem.

"Po kush e organizon?", vazhdoi ai serinë e pyetjeve.

"Organizuese e kësaj veprimtarie me sa di unë, qendrën e ka në Durrës."

"Po ftesat këtu te ne kush i shpërndan?"

"Nuk e di. Mua më lajmëruan gojarisht, po ftesë ende nuk kam marrë."

Doli qejfmbetur. Pas pak hyri sërish.

"Po ne poetët e Beratit si na lënë jashtë kësaj veprimtarie? Unë kam botuar edhe një libër të ri", m'u drejtua si të isha unë shkaktari i kësaj lënieje të tij jashtë kësaj veprimtarie dhe më tregoi librin.

"Ti mund të vish si të gjithë të tjerët, por jo për të recituar se ata që do të pezantohen me poezi janë të përzgjedhur nga organizatorët, janë pjesëmarrësit në këtë konkurs, kurse poetët baratas janë shoqëruet të këtij konkursi ngaqë jemi vendi mikpritës. Nëse kërkon ndonjë ftesë, mund të interesohesh."

Iku qejfmbetur.

Do të ishte mirë që çdo krijues beratas pavarësisht nga niveli i krijimtarisë së tij, ta kishte një ftesë për të marrë pjesë në këtë veprimtari, siç marrin pjesë edhe në veprimtari të tjera artistike.

Të dielën, para fillimit të veprimtarisë "Poeteka", e kërkova mos e shihja të njohurin tim, po nuk ma zuri syri. Ai kishte mbetur qejfprishur dhe, siç dukej, duke tundur vëllimet e tij me poezi, donte të shprehte revoltën e tij. Nuk më zuri syri midis të pranishmëve edhe shumë nga krijuesit e njohur beratas. Nuk e di pse në këtë kohë më erdhën ndër mend disa vargje të Nezim Brerit që përkonin me këtë situatë:

**Duallë ca nev zuhurë, 1)
Thonë të bëhemi shair, 2)
Qajnë gurë qajnë drurë,
Se ç'e gjet shir, o xhevair! 3)**

**Shiri një hidajet hak, 4)
S'ë si të ngrënë të kajmak;
Mos u loth, o erëzambak,
Se nukë bëhetë me pahir...**

Poeti në debatin e tij të famshëm poetik, u drejtohet disa poetëve që kërkonin të mateshin me të. Poezia, sipas poetit, është një frymëzim hyjnor dhe jo kushdo mund të bëhet poet në kuptimin e vërtet të fjalës. Poetët e mirëfilltë janë të paktë. Të tjerët janë mesatar. Shumica notojnë në cekëtitë. Prandaj kushdo që mund të ketë dëshirë të merret me poezi, s'ka pse pretendon me çdo kusht të dalë mbi të tjerët dhe ta mbivlerësojë veten dhe ta quajë padrejtësi nëse nuk e ftojnë si pjesëmarrës në një prezantim poetik. Përzgjedhja e poetëve pjesëmarrës është e drejtë e organizatorëve dhe e askujt tjetër. Dhe nëse ty nuk ta bëjnë qejfin, s'ke pse të mbetesh mënjatë qejfmbetur.

1. Jomjeshtë.
2. Poet.
3. Poezia.
4. Frymëzimi hyjnor.

Agim Mehqemeja

Një gjeneratë brezash, model në artin e kuzhinës

Para disa ditësh TVSH dha një emision të veçantë për familjen Mema, ku evidentoi vlerat, kontributin që kanë dhënë në fushën e sportit brezat e kësaj familjeje.

Në analogji mund të marr edhe familjen Matrapazi për kontributin që ka dhënë e po jep në artin e bukur të kuzhinës beratase. Ata janë, jo pak, por dhjetë.

Hekurani, ose usta Pepja bashkë me zonjën e vetë, Këzen, shquhen jo vetëm për pastërti, por dhe si mjeshtra të vërtetë sidomos në gatimin e paçes, tasqepabit, supës së prerë me limon dhe kukurecit në hell.

Rrahmani ose babaxhani i kuzhinës bashkë me zonjën e nderuar Nazmien. Ata janë dalluar për mëngjesoren, për shpirtin human dhe humorin e veçantë. Kjo mëngjesore tipike beratase dallohej jo

vetëm për mjedisin, por edhe për byrekun, të gatuar me mjeshtëri, me ato petë, siç i thoshin, kartë cigare të holla.

Usta Rrahmani mbeti dhe simbol i zemrës, për ekipin "Tomorit". Nuredini, usta me emër, njeri i punës, serioz. Ai donte rregull dhe pastërti, ndaj ai shpesh thoshte: "Higjiena në kuzhinë, klientë në tavolinë".

Usta Sybiu, urtësia, thjeshtësia, dashuria për punën, ishin tipare, virtyt i këtij njeriu, sa të respektuar nga klienti aq dhe të afruar në mjediset shoqërore.

Meti, vazhdues i stafetës, që me modesti kërkon të ruaj sado pak emrin e mirë të ustallarëve të kësaj familjeje në breza si mjeshtrë të vërtetë të menusë beratase.

Fatbardha, mbesa, ka të vetmin privilegj që i takon, sepse është e vetmja femër që ka ruajtur traditën, që ka

vazhduar stafetën. Ajo ruan me finesë, çdo gjë të bukur, të mirë që i takon artit të kuzhinës, ndaj gëzon respektin e klientëve.

Asqeri Selman Demiri, ndoshta s'ka mbiemrin e ustallarëve Matrapazi, por siç thotë populli në një fjalë të urtë: "Ka rënë dardha nën dardhë". Ai ka dhënë te familja Matrapazi. Njihet si mjeshtrë i vërtetë gati prej 40 vitesh bashkë me zonjën e vetë. Ka ushtruar me shumë aftësi e përkushtim këtë profesion që i ka dhënë nder dhe emër si në Poliçan, Kollombo, e në vende të tjera.

Ferbenti ose siç e njih grupmosha me emrin usta Beni, i cili ka një të veçantë, për të cilën duhet t'ia kenë zili ustallarët e tjerë, pastërtinë dhe fantazinë e mjeshtërisë në modelimin e sallatave në bankete të ndryshme.

Usta Beni, lokali i të cilit gjendet pranë stadiumit, me atë sjellje të një fisniku të afron të ulesh e të shijosh me kënaqësi menunë, artin e një ustai me përvojë dhe me gusto të veçantë, ndaj kur klienti largohet duket sikur e ka detyruar t'i thotë faleminderit, usta Beni, për shërbimin shembullor. Kjo e vërtetë e ka vlerën te arti i vërtetë i aftësive të këtij mjeshtri të kuzhinës, ndaj s' duhet lënë në harresë tava e baltës me plëndës, me kos, me kima, etj. Në një ekspozitë që do të çelet në Paris, vajza Enkeleida i ka kërkuar disa foto për të marrë pjesë në artin e kuzhinës.

Dëshmi e aftësive në artin e kuzhinës janë dhe vendet e punës ku ata kanë punuar, të cilat në ato vite ishin emri i mirë i menusë beratase si "Kollombua", "22 Tetori", etj.

Ata kanë punuar me



italianë e kinezë, të cilët i ka befasuar me mjeshtërinë e gatimit.

Kjo është familja Matrapazi që me punën e me ndershmëri ka lënë emër të respektuar në pasurinë e kulturës qytetare beratase, ndaj është me vlera

njerëzore për t'i bërë këta ustallarë jo vetëm të njohur, por edhe si pjesë përbërëse e trashëgimisë në artin e kuzhinës beratase, ndaj është në nderin e kulturës beratase.

Sotiraq Mishaxhu

Berati me tradita të hershme peshkimi

Vite më parë të moshuar beratas kanë treguar se lumi Osum ka patur peshk me bollëk. Me gjuetinë e peshkut nuk janë marrë vetëm njerëz që me ndonjë grep, kallam kanë kaluar kohën e lirë që ne i njohim si pasionantët e peshkimit, por edhe njerëz të tjerë që kanë qenë në numër të paktë, që e kanë patur peshkimin me leverdi ekonomike për familjen dhe këta njiheshin me emrin peshkatarë.

Më kujtohet peshkatarin nga lagjja Goricë Trifon Prifti, i njohur edhe si punues i dy rrjeteve të futbollit në vitin 1930 ku u zhvillua kampionati i parë kombëtar. Trifoni që pa gdhirë nisej për në Vodice, apo Uznovë, Bilçë dhe që nga këto vende niste gjuetinë. Merrte rrjedhjen e lumit duke gjuajtur dhe afër drekës bënte gjuetinë e fundit pranë lagjes së tij. Ky peshkatar dhe të tjerë këtë punë e bënin përditë, veç ditëve kur lumi turbullohej. Mbasdite këta peshkatarë merreshin me tregtimin e gjahut, rregullimin e rrjetës, pra gatishmërinë për gjuetinë e



Peshkatarët

ditës tjetër.

Në vitet 1960-1975 gjuetia e peshkut në Berat bëhej më e organizuar, pasi edhe shoqata gjatë kësaj periudhe quhej shoqata e gjuetarëve të peshkut. Bënte edhe një luftë kundër dëmtuesve të gjuetisë me mjete helmuese. Edhe sot vihen re tek-tuk njerëz të pandërgjegjshëm që po i sjellin shumë dëmtim peshkimit.

Në këto vite kur shoqata ishte shumë aktive, grupe-grupe

njerëzit shkonin për gjuetinë e peshkut, ashtu sikundër shkonin grupet e gjuetarëve në zonat e gjuetisë. Zakonisht gjuetia bëhej nga Bogova, Poliçani, Mbrakulla, Vodica, Uznova.

Gjuetia e peshkut, e cila është e varfëruar edhe për shkak se Osumi nuk ka aq peshk, e cila ka ardhur edhe për mënyrat barbare të peshkimit, shikojmë njerëz të pasionuar pas gjuetisë së peshkut që rrinë me orë të tëra në gjueti dhe kjo nuk

është e lidhur thjesht me leverdinë ekonomike se sa me pasionin e madh që kanë këta njerëz të etur për gjueti. Midis tyre përmendim: Lelem Kaçeli, Gaqi Gjogu, Polizoi Konomi (veteran i peshkimit), Robert Qypi, Kozma Pasku, Pirro Bushi, Stiliano Vrusho, Adrian Qytyku, Astrit Lapi, Vladimir Hysi, Dilaver Ymeri, Kozma Tuslluku, Haxhi Dyrmishi, Kiço Paftali, etj.

Vlash Pambuku



Bogovë, 1970 në peshkim Lelem Kaçeli, Nexhmedin Lybesha.

Beratasit në takimin ndaj Adës kanë bërë thjesht një formalitet sa për të respektuar kalendarin zyrtar të FSHF duke shënuar humbjen e radhës

Tomori, në gjunjë para Adës

Formacionet:

Tomori: Bytyçi (Qama 78), Aliaj, Kuçi, Pella (Çobo 70'), G. Arbri, Lala, P. Arbri (Agalliu 67'), Cufollari, Lako, Peshtanaku, Shinko. Tr. K. Mile

Ada: Dervishi, Shytani, Arra, Bori, Sh. Isufi (Palaj 46'), Pjetrani, V. Kurti, Kraja (Teluka 69'), Nika, Selmani (Matia 69'). Tr. V. Plumbini

Gjyqtarë: Kryesor: B. Pashaj (Tiranë), ndihmës: D. Koreshi (Lushnje), F. Lame (Durrës). K. verdhë: Kuçi, Arra

Shënues: Nika 22', Selmani 31', P. Arbri 40'

Takimi i javës së parafundit i zhvilluar në Stadiumin "Tomori" të Beratit midis Tomorit vendas dhe Adës mike, është përshkruar që nga minuta e parë deri në vërshëllimën e fundit të gjyqtarit nga një monotoni, që zor se mund të përsëritet në ndonjë kampionat tjetër. Fakti që Tomori ka vënë nën pronësi të tij vendin e gjashtë dhe Ada lufton për të mbijetuar në kategorinë e parë ka sjellë në fushën e lojës dy pamje krejt të kundërta: një Tomor që impenjohet pak dhe një Adë që kërkon të marrë atë që nuk mund ta arrij përballë një skuadre me traditë në futbollin shqiptar. Teknikët e të dyja skuadrave, si Mile i Tomorit ashtu edhe Plumbini i velipojasve i kanë besuar një skeme me shumë lojtarë në mesfushë dhe me dy sulmues në vijën e parë, çka ka sjellë një përshtjellim në mesfushat respektive duke rrezikuar pak ose aspak portierët respektivë. Pjesa e parë ka konfiguruar një mozaik aksionesh që gjithsesi nuk janë kurorëzuar ashtu siç duhet, për faktin që skuadrave u ka munguar fuqia finalizuese. Tomori edhe pse ka patur një epërsi të lehtë në të gjithë sektorët dhe është munduar që ta mbajë lojën nën kontroll, nuk ka mundur të zgjidh situatën që në këtë pjesë duke manifestuar një mungesë të dukshme dëshire. Sulmuesit P. Arbri dhe Peshtanaku, të dy me përvojë të

pakët, nuk janë mbështetur si duhet nga mesfusha, ndërkohë që miqtë nga Shkodra i kanë kushtuar vëmendje të veçantë mbrojtjes me qëllim që të mos pësonin gol që në minutat e para. Madje miqtë kanë mundur ta mbyllin pjesën e parë në favor të tyre duke shënuar dy herë: në minutën e 22 kapiteni Nika i ndodhur në zonën vendase ka përshëndetur rrjetën e Bytyçit ndërkohë që Selmani në minutën e 31 e çon rezultatin në 2:0. Beratasit arrijnë të shkurtojnë në minutën e 40 kur pas një kombinimi të bukur të vëllezërve Arbri, P. Arbri godet fort dhe mposht portierin mik Dervishi. Pjesa e dytë ka qënë pa ndonjë impresion për të dyja skuadrat të cilat kanë patur objektiv, Ada administrimin e rezultatit të pjesës së parë dhe Tomori barzimin e tij. Beratasit mundohen të tregohen më racionalë dhe më këmbëngulës në kërkim të golit që do ti çonte drejt një trepikëshi me vlera të dyfishta morale, ndërsa miqtë shpresuan deri në fund se mund të merrnin 3 pikë që do ti largonte nga zona e ftohtë e kategorisë së dytë dhe duhet thënë që ia arritën qëllimit. Përfundimisht Tomori shënon rekordin e humbjeve në shtëpi, ndërsa Ada ngrohet me një trepikësh që do ta mbajë në lojë për të qëndruar në kategorinë e parë.

Opinione:

Th., Arbri Tomori: "Ishte një takim ku të dyja skuadrat e kërkuan fitoren. Ada për vetë pozicionin delikat luajti më mirë dhe e meritoi fitoren. Tomori vuri në provë shumë lojtarë të rinj me lojën e të cilëve jam i kënaqur".

V. Plumbini, Ada: "Kishim shumë nevojë për një fitore të tillë dhe ndihem i kënaqur që e arritëm. Luajtëm mirë dhe shënuam dy gola që në pjesën e parë. Në pjesën e dytë skuadra diti që të administronte rezultatin duke marrë 3 pikë mjaft të vlefshme. Shpresojmë që me këtë fitore të qëndrojmë në kategorinë e parë".

Rushan Dosti



Përgatiti Vangjel Buda

MEKSIKË 1986

Meksikës iu dha për të dytën herë e drejta e organizmit të finaleve për Kampionatin e 13 Botëror të Futbollit në vitin 1986

Finale me peripecira

Finalja e 26 qershorit 1986, do të mbahet mend, për faza të çuditshme të lojës. Po le t'ia lëmë para së gjithash fjalën rezultatit të ndeshjes.

26.06.1986 në Meksiko, stadiumi "Azteka": Argjentinë-RFGJ 3-2.

Shënues: 22' Braun, 55' Valdano, 83' Buruçaga/ 73' Rumenige, 81' Fëler.

Gjykoj: Arni Filio (Brazil). Shikues 95 000.

Argjentina: Pompidu, Kuçufio, Olargiocea, Batista, Ruxheri, Braun, Buruçaga (89' Trobiani), Xhiunti, Enrike, Maradona, Vladano.

RFGJ: Shumaker, Bertold, Breme, Jakobs, Fëster, Brigel, Edel, Mateos, Rumenige, Magat, (61' Henes), Alofs (46' Fëler).

Dy shkolla futbollit

Në këtë finale u ndeshën dy shkolla të ndryshme futbollit. RFGJ me psikologjinë e saj prej skuadrave me eksperiencë dhe të organizuar, në anën tjetër Argjentina me Maradonën të rrethuar nga Valdano dhe Ruxheri.

Kur dukej se gjithçka që vendosur dhe latinët kryesonin 2-0, si shumë herë të tjera, gjermanët barazojnë në 2-2 dhe morën në dorë frenat e lojës. Në këtë moment ndërhyri ai i vogli, i shëmtuari, magjistari Maradona. Duke dhënë një pas të pagabueshmit Buruçaga, kur goli i këtij të fundit, vuri Argjentinën në podiumin e nderit të Kupës së Botës.

Duhet thënë se në këtë ndeshje portieri gjerman Shumaker, ishte në një ditë të errët, kur pësoi ato dy gola e parë dhe kur lëshoi minutat e fundit i ngutur atë top me dorë, që i shkaktoi humbjen skuadrës gjermane.

Trajneri i Argjentinës Bilardo ishte doktor gjinekologjik. Braktisi mjekësinë për futbollin. Megjithatë ai arriti të drejtojë përfaqësuesen e Argjentinës në këtë finale dhe u shpall bashkë me skuadrën fitues i Kupës së Botës më 1986.

Pas ndeshjes katër bodigardë të armatosur gjer në dhëmbë ruanin Maradonën. Gazetarët thanë se kaq shumë nuk ruhej as Preidenti i Republikës, apo Papa i Romës.

Më të shquarit e Botërorit 1986

1. Maradona (Argjentinë).

Historia e një mëkati. U lind më 30.10.1960, në Lanus. Talenti i tij shkëlqeu shumë shpejt. Më 1978 Menoti e mori me vete për të ndjekur botërorin e atij viti, Pele i ri dhe futbollisti më i mirë i shekullit (bashkë me brazilianin Pele), fatkeqësisht nuk ishte në gjendje dhe të sillej mirë. Karakteri i tij i vështirë, kokaina dhe edukata i kushtuan karrierën këtij ylli që u plak shpejt.

2. Mishel Platini (Francë).

Ishte bir i një emigranti italian. Platini u bë lojtari më i mirë i Francës. Tri herë u votua si më i miri i Evropës për Topin e Artë dhe më së fundi mori dhe çmimin e artë të FIFA-s.

3. Sokrates.

Braziliani, një ndër mesfushorët më të mirë të Brazilit. Luajti 63 ndeshje me kombëtaren braziliane. Paralelisht me futbollin ishte ndër të vetmit që studioi për mjekësi, profesion që vazhdon ta ushtrrojë edhe sot.

4. Geri Lineker (Angli).

Lojtari elegant, golashënuesi më i mirë i kohës në Angli dhe në botërorin e vitit 1986. Ishte lojtari që e çoi në çerek finale Anglinë.

Golashënuesit më të mirë

Geri Lineker, Angli me 6 gola.

Emilio Butragenjo, Spanjë; Antonio Kareka, Brazil; Diego Maradona, Argjentinë me 5 gola.

Igor Belanov (B.S); Aleksandro Altobeli, Itali; Horze Valdano, Argjentinë me 4 gola.



Mendimi i teknikut

Çfarë do të mbahet mend nga historia e këtij botërori?

Në radhë të parë konfirmimi i futbollit afrikan, me përfaqësuesen e denjë të saj Marokun, i cili mbeti në barazpeshë me më të mëdhenjtë e botës. U tha Maroku i vogël me futboll të madh, ose më tutje Paraguai, Belgjika dhe Danimarka që sfiduan të mëdhenjtë. Do të mbahet mend finalja që ashtu si nisën ndeshjet e para në grupe, të paktën kishin atë që mendonin se do të luante në finale Argjentina me RFGJ-në. Por ishin pikërisht këto dy skuadra, të dy trajnerëve aq të sulmuar nga komentatorët e vendeve të ndryshme, sidomos Franc Bekenbaueri, juridikisht pa qenë i diplomuar si trajner, i ashtuquajtur i lojtar i madh dhe trajner që don të zhvërtetizojë stilin autentik të futbollit argjentinës. Por që të dy teknikisht heshtën dhe i duruan sulmet dhe fituan. Por një gjë është e qartë se Bilardo diti t'i jepte shpirt skuadrës së tij duke futur në lojë një futbollist magjik, Diego Armando Maradonën, kur thuhet i ngadalshëm, por edhe i shpejtë, sulmues dhe mbrojtës, krijues e teknik, i ashpër dhe i butë. Argjentina duke përfaqësuar denjësisht amerikën latine në këtë botëror kishte arritur 6 fitore, vetëm një barazim duke mos patur asnjë humbje.

Kam nostalgji edhe për tifozët

Duke punuar gjithmonë pranë sportit, fillova të admirojo vetëm sportistët, trajnerët, gjyqtarët, veprimtarët, por edhe tifozët e zjarrtë. Tashmë që kanë kaluar vite, ashtu si për të gjithë, edhe për tifozët e zjarrtë kam nostalgji të veçantë, ndaj edhe po shkruaj për njërin prej tyre.

Ishin vite kur tifozëria në Berat ka qenë në kulm. Kjo ishte e lidhur me nivelin e lojërave, me rezultatet

dhe me yjet që kishte në përbërje ekipi i "Tomorit".

Bëhet fjalë për periudhën 1977-1990. Në këtë dyndje tifozërie shfaqej plot optimizëm, humor, dinamizëm e me sakrifica ashtu si shumë tifozë edhe Berti (Robert Sinjari), tifozi më në zë i "Tomorit".

Dihet që çdo tifoz ka histori të shumta, të gëzueshme dhe jo të këndshme dhe Berti ka historitë e veta.

Do të tregoj vetëm dy, që i kam parë nga afër.

Berti! Berti!

"Tomori" do të luante në Kuçovë. Tifozëve të Beratit u ishte bërë barrikadë që të mos qarkullonin me autobuzë në Kuçovë. Kjo kishte bërë që shumë tifozë të marrin rrugën me këmbë.

Atë ditë udhëtova me makinën e Bertit. Rrugës e ndali disa herë makinën duke e mbushur me tifozë. I mbeti peng që një grup tifozësh pranë Urës-Vajgurore nuk mundi t'ua plotësojë dëshirën.

Sapo makina mbërriti pranë stadiumit të Kuçovës, Berti bërtiti: "Zbrisni! zbrisni shpejt!" Ktheu makinën dhe mori rrugën për në Urën Vajgurore. Dikush i foli se ata po vijnë, por Berti ia ktheu: "Kur të vijnë ata, loja do të ketë mbaruar"

Tifozët kur panë makinën e Bertit, bërtitën të gëzuar: "Berti! Berti!" Makina mbërrin ndërkohë që ekipet po delnin në fushë. E kur ata e falënderuan Bertin, ai

u thoshte: "Tifozi bën për tifozët."

Lot gëzimi

Më kujtohet atmosfera që u krijua në stadiumin e qytetit tonë fill pas përfundimit të takimit me "Besëlidhjen", 1977, kur "Tomori" hyri në kategorinë e parë. Më janë fiksuar disa detaje nga ajo atmosferë e gëzueshme e midis tifozëve edhe me Bertin. Fill pas përfundimit të ndeshjes shikoi Muhamet Arapin (Pepën) "Babanë e tifozëve" siç e quanin në Berat, që e kishin ngritur në krahë një grup tifozësh dhe e shëtisnin nëpër pistën e stadiumit shoqëruar me brohoritje. Pepja nxirrte karamelle nga xhepi dhe gostiste tifozët dhe uronte: "U faleminderit çunave!" Afrohem dhe fiksoj me aparat disa pamje. Vura re edhe Bertin që bërtiste i gëzuar dhe i mbushur në lot. Ishin lot gëzimi. Dhe ashtu si Berti vura re edhe tifozë të tjerë të lotuar.

Sot më ka marrë malli të shikoj



Robert Sinjari

atmosfera të tilla, por ekip që ta justifikojë dhe nëse po të ndodhë që të kemi ekip me siguri do të shikojmë se do të shfaqen tifozë të zjarrtë që sakrifikojnë ashtu sikundër i ndjeri Robert Sinjari.

Vlash Pambuku

"Tomori" në kampionat zuri vendin që meritoi

Bisedoja një ditë me sportdashës. Ndër të tjera u them se ekipi i futbollit "Tomori" në këtë kampionat zuri vendin që meritoi. Ata ma kundërshtuan këtë mendim. Atëherë nisa t'u spjegoj përse kisha të drejtë. Në fazën e parë u thashë "Tomori" doli në krye të tabelës. Kjo erdhi sepse në përbërje të ekipit kishte futbollistë cilësorë që luajtën me nivel dhe me dëshirë për fitore. Ekipi u konsolidua dhe hyri në rrugën e fitoreve që ndikonte edhe procesi stërvitor i mirë dhe kujdesi që u tregua në përgjithësi për ecurinë e ekipit. Këto dukuri pozitive bëri që "Tomori", u them, të zërë vendin që meritoi.

Në fazën e dytë, u them, që nga muaji janar e deri në prag të kësaj faze, ju e dini, mirë se sa e turbullt ishte gjendja e ekipit. Të gjithë ishin të shqetësuar përse ekipi nuk po vihej në udhë, pasi edhe mbledhjet e gjata nuk po jepnin fruit. Nuk po dinim jo vetëm ne, por edhe futbollistët e stafit se kishte apo jo president. Në këto rrethana na braktisën nga ekipi disa futbollistë e ndonjë trajner. Sa për nivelin dhe rezultatet e ndeshjeve i dini mirë. Tomori kthehesh në Berat pa pika, ndërsa në Berat ekipet po na i rrëmbenin pikët. Atëherë kur ekipit i erdhi fundi, zgjati dorën dhe filloi që të lypë pikë tek "Flamurtari" dhe "Apolonia". Të dy këto ekipe nuk na falën pikë por na gostitën me gola.

Ja, pra, përse them se "Tomori" zuri vendin që e meritoi, sepse në fund të fundit nuk u bë ndaj tij ndonjë padrejtësi që të ndikojë në rezultat. Së fundi nëse "Flamurtari" dhe "Apolonia" do të na falnin pikë, do të ishim më lart në tabelë, por do të ishte një vend i pamërituar.

Pra, "Tomorit" nuk i takonte ai vend, por ky vend që u rendit.

Si fola e fola, i pyeta: "A nuk është kështu?"
Ata më dhanë të drejtë.

Vlash Pambuku

TAEK WON – DO

Objektivi i beratasit Florian Sulejmani është që në Kampionatin Ballkanik të këtij viti të renditet midis tre më të mirëve të Ballkanit

Florian Sulejmani, kampioni që kërkon medalje ndërkombëtare



Florian Sulejmani

"TAEK WON-DO" është një ndër sportet më të reja që ka nisur të marrë jetë pas viteve 1990. Në qytetin e Beratit ky lloj sporti sa spektakolar, aq edhe burrëror starton për herë të parë në vitin 1996, kur një grup të rinjsh krijuan skuadrën e parë të "TAEK – WON-DO" në kuadër të Klubit Sportiv "Tomori". Nismëtarë të kësaj tradite sportive të re ishin i talentuari Gjergj Bobo, Florian Sulejmani, etj. rreth të cilëve u mbledhën shumë emra të tjerë. Edhe pse pa snjë kusht e mundësi materiale për ta ngritur këtë lloj sporti, ata mundën t'ia dilnin mbanë, madje të arrinin

rezultate shumë të mira individuale dhe ekipore. Një ndër ta që vazhdon të përfaqësojë "Tomorin" si dhe të jetë antar i ekipit kombëtar të "TAEK-WON-DO" është dhe i talentuari Florian Sulejmani, i cili pasi ka merituar disa tituj të lartë kombëtar, kërkon që të marrë një medalje nderi në aktivitetin e ardhshëm ballkanik që pritet të zhvillohet në Shqipëri. Vetë Sulejmani, i cili është shpallur kampion kombëtar për pesë vite rresht dhe konkretisht më 2001, 2002, 2003, 2004, 2005, shprehet se ky aktivitet për herë të parë ka filluar më 5 shkurt 1996 dhe ai

më 1999 ka fituar titullin nënkampion kombëtar. "Personalisht vazhdoj të jem i angazhuar maksimalisht me përgatitjet për t'u përfaqësuar me ekipin kombëtar në Kampionatin Ballkanik që do të zhvillohet së shpejti, për të cilin kam objektiva konkrete. Aktualisht stërvitem intensivisht me dy séanca në ditë për të arritur qëllimin që i kam vënë vetes për të qënë mes 3 më të mirëve të Rajonit Ballkanik. Ky motivim ka të bëjë edhe me faktin se dua të vë në vend një padrejtësi që më është bërë kampionatin e kaluar në Larisë të Greqisë ku unë e hodha kundërshtarin nokaund, por gjyqtari më ndëshkoi me faull të paqënë duke më skaulifikuar nga gara", - shprehet kampioni beratas Florian Sulejmani. Nën përgatitjen e trainierëve të ekipit kombëtar Jani Kamberi dhe Aleks Bega, Sulejmani synon që të zërë një vend nderi dhe pse jo të marrë një titull të lartë në këtë kampionat ballkanik.

Rushan Dosti



ProCredit Bank

Me ne pranë, ju shkoni larg!



Ti mund të përmirësosh punën tënde,
me kredi në Bankën tonë!

Kushte më të mira,
Afat më i gjatë,
Procedurë më e shpejtë.

04 240 777